



# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.1(427)

JANAR 2024

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtë: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI &amp; BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

## OPINION



**RISHKRIMI I HISTORISË TI SHËRBEJË BASHKIMIT DHE JO PËRÇARJES**

**SHPENDI TOPOLLAJ****FAQE 7**

## TOPONIMET



Xhemal MEÇI - Studiues, "Mjeshtër i Madh"

**PROFESOR EQEREM ÇABEJ NË KABASH TË PUKËS**

**FAQE 6**

## LIBRI

Kriteri shkencor kronologjik, i ndjekur nga autorë Mihallaq Konda i ka dhënë librit vërtetësi dhe besueshmëri

**Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj****FAQE 9**

**VLERAT DHE DUKURITË E REJA TË HISTORIKUT TË BRIGADËS SË IV S**

Ndër ngjarjet më të rëndësishme të historisë së re të Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi

## 80 VJETORI - KONFERENCA E BUJANIT GURTHEMEL I SHTETËSISË SË KOSOVËS

## QWERTYI

**PËR BUJANIN, KU U PROJEKTUA VETËVENDOSJA**

**Halil RAMA - Mjeshtër i Madh**

Bujani i Krasniqes, me shumë bëma në historinë tonë kombëtare, hijerëndë dhe kreshnik në prehrin e Malësisë së Gjakovës, mbi të gjitha njihet për kuvendin e tij historik, nga ku 80 vjet më parë u ideua e drejta e vetëvendosjes së kosovarëve për të ardhmen e Kosovës dhe bashkimin e saj me Shqipërinë.

Pikërisht në 80-vjetorin e Konferencës së Bujanit, sala "Teki Dervishi" në bibliotekën "Ibrahim Rugova" të qytetit Gjakovë mbloodi në një akademie soleme pasardhësit e atyre burrave trima e të mençur, që 80 vjet më parë, shpallën shprehjen e vullnetit të shqiptarëve për bashkim kombëtar, dhe me rezolutë, edhe njohjen Kosovës të së drejtës për vetëvendosje deri në shkëputje nga ish-Jugosllavia. Personaliteti nga Prishtina, Gjakova, Prizreni, Tropoja e Tirana, pasardhës të protagonistëve të atij kuvendi legjendar – ndër të cilët edhe i Lekë Hoxha, biri i burrështetasit Kosovar Fadil Hoxha, ideator dhe ndër firmëtarët kryesorë të rezolutës së këtij kuvendi historik, si dhe vëllai i tij Skënder Hoxha, ndjejnë një kënaqësi të veçantë, një krenari legjitim, për Bujanin e Malësisë së Gjakovës, për Bujanin e Krasniqes, për Bujanin, në hullitë jetësore të të cilit ecën koha e cila nuk jeton dot pa historinë e saj. Dhe për këtë, sikur duan të flasin të gjithë, edhe kulla, edhe kalatë..., edhe këngët e vallet epike të interpretuara me mjeshtri të rrallë nga djem e vajza shtatlarta të truallit të Dardanisë. Burim frymëzimi për ne dhe për brezat që do të vijnë, libri "Konferenca e Bujanit, Gurthemel i shtetësisë së Kosovës" i autorit Dr. Alban Dobruna, botim i Institutit të Historisë Prishtinë.

**VIJON NE FAQEN 2**

• Njëri nga bartësit kryesor të këtyre ideve në Bujan dhe nismëtar i orëve të para të punës konkrete ishte mësuesi nga Gjakova, Fadil Hoxha, komunist me bindje, më vonë një nga udhëheqësit kryesorë të Kosovës dhe një nga udhëheqësit më të lartë të Jugosllavisë Federative

**Nga Dr. Alban Dobruna**

## PORTRETE

**DËSHMORËT PJESMARRËS NË KONFERENCËN E BUJANIT**

**Nga Xhavit LASHI****FAQE 4**

Faksimili i dokumentit me nënshkrime të pjkësëmarrësve të Konferencës së Bujanit

## SUPPLEMENTI LETRAT



**Një libër tjeter mbi Ali Pashë Tepelenën dhe Bushatlinjtë**

**Nga Vasil PREMÇI****FAQE 4****FAQE 14 - 15**

**Paradokset e një kryeqyteti**

**Tregim nga Liljana Muca****FAQE 13**

## HISTORIA

**RRUGA E LAVDISHME E BRIGADËS SË 6-S**

**FAQE 11**

## REPORTAZH

**GJETHE KUJTIMESH TË DRITERO AGOLLIT NË KRYEZI TË PUKËS**

**Sefer Pasha****FAQE 8**

## ESSE

**PËR KOSOVËN, VITI 2024, VIT I SHPRESAVE MË TË MËDHA**

**Nga Bashkim Hisari****FAQE 10**

## ATDHEDASHURIA

**VELMISHI NË GJURMËT PATRIOTIKE**

**Nga Nuri Buçi****FAQE 12**

## 80 VJETORI

Konferenca e Bujanit u projekoi rrugën që duhej ndjekur në vazhdimin e LANÇ dhe për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare



**Halil RAMA – Mjeshter i Madh**

(vijon nga fq. 1)

Si një testament atdhedashurie, mesazhet që përcillen nga ky libër për sakrifica të mëdha të tre brezave, për të arritur këtu ku jemi sot: Kosova e lirë – shtet sovran e demokratik, populli shqiptar kudo që jeton në trojet e veta etnike i ka fituar të drejtat nacionale e po shkon drejt konsolidimit të tyre. Një libër që i flitet historisë...

**KONFERANCA QË PROJEKOI RRUGËN PËRZGJIDHJEN E ÇESHTJES KOMBËTARE SHQIPTARE**

**N**ë Konferencën e Bujanit, u projektua rruga që duhej ndjekur në vazhdimin e Luftës Nacional çlirimtare për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare, e cila nuk gjeti zgjidhje deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, por platforma dhe programi i kësaj konferenca mbetën udhërrëfyes për zgjidhjen e problemit shqiptar në Ballkan.

Konferena e Bujanit na kujton një nga ato ditë të zjarrta të historisë moderne shqiptare, që përfshin Shqipërinë dhe Kosovën dhe ata gra e burra, komunistë e nacionalistë, atdhetarë e demokratë, përfaqësues të forcave të armatosura dhe të rinj antifashistë, që shënjuan një gur themeli në të nesërmend dhe vizonin për të ardhmen e çështjes shqiptare.

Gjeneral Rrahman Parllaku, Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit –ish kryetar OBVL, është sesionin jubilar të para dhjetë viteve (organizuar nën kryesimin e ish kryetarëve të parlametarëve të Kosovës dhe Shqipërisë, Jakup Krasniqi dhe Ilir Meta) e ka vlerësuar Konferencën e Bujanit si një eveniment kombëtar, jo vetëm për Kosovën, por për gjithë Shqipërinë. Sepse në këtë Konferencë u shtrua për zgjidhje çështja kombëtare shqiptare. Kjo konferencë ballafaoqi shqiptarët e të dyja anëve. “Konferenca e Jaltës kishte vendosur që shteteve që ishin pjesëtare të aleancës Antifashiste të popujve nuk i ndryshoheshin kufijtë. Kishin lënë një klauzolë, kur të dy popujt janë në anën e luftës Antifashiste marrëdhëni do të zgjidheshin në mënyrë bilaterale, dmth do merren vesh me njëri tjetrin përtë zgjidhur problemet. Ky vendim për bisedime midis shqiptarëve dhe jugosllavëve nuk u realizua. Si fillim konferencën e Bujanit ata e zhvlerësuan. Duhet të themi se edhe nga ana shqiptare nuk pati një këmbëngulje, një përpjekje përtë diskutuar këtë problem. Nuk gjemjë një dokument, ku të tregohet se është ulur udhëheqja shqiptare me udhëheqjen jugosllave përtë kërkuar Kosovën”, ka deklaruar gjeneral Parllaku.

Le t'i referohemi në prag të 80-vjetorit të kësaj ngjarjeje të shënuar edhe deklaratës që kryeministri Albin Kurti ka bërë pesë vjet më parë, në tryezën e organizuar nga Lëvizja Vetëvendosje, se konferenca e Bujanit ka qenë një konferencë e gjërë e frontit antifashist të Kosovës, dhe aty kanë marrë pjesë përfaqësues të të gjitha shtresave e krahinave të Kosovës.

Kurti, atëherë kryetar i vetëvendosjes, ka thënë se kjo konferencë është tejet e vlefshme si moment i rëndësishëm i Republikës së Kosovës. Kjo, sipas tij përfaktit “Kjo konferencë, edhe pse thuajse është heshtur përtë, dhe nuk njihet siç duhet nga qytetarët, është tejet e vlefshme, si një nga momentet e rëndësishme kur populli i Kosovës, ndërkohë që rrështohet kundërfashizmit si shumë popuj të tjerë të botës, në të njëjtën kohë, afirma të drejtën e vet për Vetëvendosje, dhe dëshirën e vet të kahershme e të vazhdueshme përtu bashkuan me Shqipërinë. Rezoluta e Bujanit, e cila i përban pikërisht këto shprehje, u votua prej të gjithë pjesëmarrësve, përfshi edhe atyre serbë e malazezë.”

**ÇFARË PËRMBANTE REZOLUTA E BUJANIT**

Aspiratat e atyre burrave të kombit, të shprehura mirëfilltazi në Rezolutën e Konferencës Historike të Bujanit janë aktuale edhe sot, kur më shumë se kurrrë, bashkimi kombëtar është imperativ i ditës. Në një artikull të studjuesit Xhavit Lashi, botuar në vëllimin e dytë të librit “Dëshmorët në rrënjet e kombit shqiptar” (botim i Organizatës Kombëtare përdëshmorët e LANÇ dhe dëshmorët e tjerë të Atdheut në tetor të këtij viti,

# Për Bujanin, ku u projektua vetëvendosja

- *Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçilirmtare në Kosovë u krijuan 8 brigada kosovare dhe disa njësi të tjera ushtarake partizane ku, u përfshinë 53000 kosovarë nga të cilët rreth 6200 prej tyre ranë dëshmorë*
- *ADEM DEMAÇI: “Konferenca e Bujanit është kryevepra politike e Fadil Hoxhës nga e cila ai, pavarësisht nga katrahurat e shumta që kaloi Kosova nën sundimin serb, nuk hoqi dorë nga parimet e saj”*



fq. 158), ndërt të tjera na njeh se çfarë përbante Rezoluta e Bujanit. Në pesë pika të saj qartësohet se:

- Kosova e Rrafshi i Dukagjinit janë të banuara kryesisht nga Shqipëtarët;
- Shqipëtarët e Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, si gjithmonë në të kaluarën, ashtu edhe sot dëshirojnë bashkimin me Shqipërinë.
- Rruja më e mirë për Shqipëtarët që të bashkohen me Shqipërinë është lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë, kundër pushtuesit dhe shërbëtorëve të tij.
- Populli Shqipëtar i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit do të ketë mundësi të caktojë fatin e vet, si rezultat i luftës kundër pushtuesit.
- Përcaktimi i fatit të vet përfshin edhe të drejtën e vetvendosjes deri në shkëputje.


Me gjithë debatet e zhvilluara, Rezoluta u mirua njëzëri. Dokumenti i Rezolutës është shkruar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbo-kroate, nga Xheladin Hana me atë shkrinin e tij të qartë e të bukur. Në fund të gjithë delegatët të ngritur në këmbë me grushin lart, kënduan internacionalen.

Nga pjesëmarrësit në Konferencën e Bujanit pat edhe dëshmorë që derdhën gjakun për çlirimin e atdheut si Hajdar Dushi, Xhevded Doda, Xheladin Hana, Jah Salih Mani, Tefik Çanga etj.

**KUVENDI I IDEALEVE TONA KOMBËTARE**

Krahas shumë ngjarjeve kulmore historike të kësaj krahine, folësit në këtë akademi përkujtimore, do të evidentonin kontributin e veçantë të Bujanit dhe Malësisë së Gjakovës përvienien në jetë të vendimeve të Konferencës historike që u mbajt më 31 dhjetor 1943 dhe më 1 e 2 janar 1944 në kullën e patriotit Sali Mani.

Po ashtu dhe Brigadën e 25 Sulmuese të drejtuar nga Veli Nimani me 900 forca (700 nga Tropoja e 200 nga Hasi) dhe katër batalione që drejtosheshin nga Idriz Rexhep Mulosmani, Ali Brahim Mustafaj, Mehmet Bajram Mulosmani dhe Ismail Poga, që së bashku me brigadat kosovare çliran territoret nga Kosova deri në



Sanxhak të Bosnjës. Në këtë akademi soleinne spikati mendimi teorik e shkencor i disa studjuesve, duke e konsideruar Konferencën e Bujanit si kuvenden e idealeve tona kombëtare. Përfaktin se Malësia e Gjakovës ka qenë pjesë e pandashme e Gjakovës si qendër urbane, referuesit argumentuanj se ato historikisht janë ndihmuar e kanë vepruar së bashku në përpjekjet dhe luftërat e tyre përliri e pavarësi. Kjo përfaktin se qyteti i Gjakovës s'bënte asgjë pa Malësinë e tij, sikurse edhe ajo do t'i shërbejë si mbështetja kryesore sa here kërcenohej Gjakova dhe mbarë Kosova nga zullumet e të huajve, tha ai ndërt të tjera. Kështu ndodhi edhe në Luftën e Dytë Botërore, kështu do të ndodhë edhe në vjetin 1998-1999.

Nisur nga këto premise nga kjo akademi përkujtimore u konkludua se Konferenca e Bujanit zë një vend të veçantë në historinë e re shqiptare, si një afirmim i fuqishëm i identitetit politik të Kosovës dhe i vullnetit të popullit të saj për bashkim kombëtar.

Nga e njëjtë optikë, përcillet edhe sot pas 80 vjetësh historia e Bujanit si një prej fshatrave më me zë të fisit të Krasniqes e më gjërë, të vendosur afër qyteteve ilire të Rosujës, të cilat sipas gjermimeve arkeologjike dëshmojnë përvazhdimësi jete tremjë vjeçare, me një besim e kulturë të hershme, që dëshmohet me xhaminë e ndërtuar këtu që në vitin 1786, e cila kishte edhe menjepin, shkollën e ulët fetare ku mësonin shkrim e matematikë, e më vonë hapjen e të parës shkolle laike në gjuhën shqipe në Malësinë e Gjakovës në shtëpinë e Ali Jakupit në Dojan me 17 tetor 1922.

**NË 8 BRIGADAT PARTIZANE 53000 KOSOVARË**

**NGA TË CILËT 6200 RANË DËSHMORË**

“Ndërt shtyllat e fuqishme të shtetit të ri në Kosovë mund të konsiderohet organizimi i Konferencës së Bujanit, pasi ajo u mbështetet në Karten e Atlantikut me të cilën garantohej vetëvendosja, pastaj Deklarata e

(Vijon në fqan 3)

## 80 VJETORI



**Konferenca e Bujanit u projekoi rrugën që duhej ndjekur në vazhdimin e LANÇ dhe për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare**

(Vijon nga faqja 2)

Moskës, Rezoluta e Teheranit dhe Deklarata e Jaltës, ku thuhej: "Gjithkush në tokë të vet e gjithsejçili të vendosi mbi formën e qeveris së vetë", tha ndër të tjera Dr. Alban Dobruna në referatin që mbajti në këtë Akademi Përkujtimore. Ai argumentoi se organizimi i Konferencës së Bujanit ishte një domosdoshmëri e kushtëzuar nga nevojë për t'i bindur masat shqiptare me një akt të besueshëm ashtu që të mobilizohen në luftë kundër fashizmit. Pra, për t'i frysmezuar ata që me të drejtë nuk i besonin ardhmërisë së pas luftës, arriten të bidnin një pjesë të popullit për angazhimin aktiv në këtë luftë, duke projektuar bindshëm vizionin e së ardhmes. Ishte ky besim i patundur i masës së gjës të popullit kosovar që mundësoi krijimin e 8 brigadave kosovare dhe i njësive të tjera ushtarake partizane ku, u përfshinë 53 000 kosovarë nga të cilët rreth 6200 prej tyre ranë dëshmorë.

"Aq sa ishte e vështirë dhe e ndërlikuar Lufta e Dytë Botërore në Kosovë kundër armikut, aq më e madhe është merita e lavdia e atyre që u hodhën në luftë dhe e organizuan rezistencën e saj. Njëri nga bartësit kryesor të këtyre ideve në Bujan dhe nismëtar i orëve të para të punës konkrete ishte mësuesi nga Gjakova, Fadil Hoxha, komunist me bindje, më vonë një nga udhëheqës i kryesorë të Kosovës dhe një nga udhëheqës më të lartë të Jugosllavisë Federative", tha Dr. Dobruna. Në këtë vlerësim ai i referohet luftëtarit më të paepur përlirinë e mendimit, Adem Demaci, mbrojtës më këmbëngulës të lirive dhe të drejtave të njeriut të cilit Parlamenti Evropian, më 4 dhjetor 1991, i dha Çmimin Saharov, që është shprehur se "Konferenca e Bujanit është kryevepra politike e Fadil Hoxhës nga e cila ai, pavarësisht nga krahurat e shumta që kaloi Kosova nën sundimin serb, nuk hoqi dorë nga parimet e saj"

#### VIZITË MBRESËLËNËSE NË KULLËN E PATRIOTIT SALI MANI

Në vigjilje të 80-vjetorit të këtij kuvendi historik kujtoj një vizitë nga më mbresëlënëset të para dhjetë viteve me të ndjerin gjeneral Rrahman Parllakun – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit dhe dhjetra personalitetë nga Prishtina, Tirana, Gjakova e Tropoja, në kullën e patriotit Sali Mani, në Bujan të Krasniqes, ku me 31 dhjetor 1943 e deri më 2 janar 1944 zhvilloj punimet me sukses të plotë Konferencia Themeluese e Këshillit Nacionalçirimitar për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit.

Në podin karakteristik të kësaj kulle, në analet e historisë sonë të lavdishme, foto dhe fakte nga jeta e 49 delegatëve përfaqësues të viseve të Kosovës, prej të cilëve 43 ishin shqiptarë dhe 6 serbë e malazez. Pikerisht në ato tre ditë e netë të zjarrta të atij dimri të furishëm në këtë kullë u bëni diskutime e debate të vlefshme si dhe u miratuan dokumente të rëndësishme për punën e mëtejshme si: Proklamata drejtuar popullit të Kosovës, Rezoluta, detyrat prej 18 pikash për KNÇ-të si dhe telegramet përshtëdetëse.

Pa dyshim se pjesa më e rëndësishme e Rezolutës së Konferencës është ajo që bën fjalë për të drejtën e patjetërsueshme të popullit të Kosovës për vëtëvenosje.

Aty pa ekuivoke thuhej: "Kosova e Rrafshi i Dukagjinit asht një krahinë e banueme me shumicë nga populli shqiptar, i cili si gjithmonë, ashtu edhe sot, dëshiron me u bashkue me Shqipni..."

Në konferencë u shtruan për zgjidhje dy çështje fundamentale: e para formimi i Këshillit Nacionalçirimitar të Kosovës, i cili do të identifikohej me individualitetin e subjektivitetit politik-shtetëror të Kosovës dhe e dyta, do të ishte zgjidhja e çështjes kombëtare për të ardhmen e shqiptarëve.

Përvlerat e kësaj konference të rëndësishme atë ditë folën ish - kryetari i Shoqatës të Veteranëve të LANÇ të Kosovës, shkrimitari Vehap Shita, general Parllaku dhe shkrimitarja disidente Flora Brovina

#### TESTAMENT I ATDHEDASHURISË

80 vjet më pas, Bujani shpaloset me tërë madhështinë e tij, i shtronjtë, i bukur, përmendore e historisë sonë kombëtare! Bujani është i privilegjuar nga vetë natyra, me një pozitë gjeografike mjaftë të favorshme,

# Për Bujanin, ku u projektua vetëvendosja



duke filluar nga brigjet e lumit Valbona, vijon gjatë përroit të Gradazhnicës, që e ndan me fshatin Gri, vazhdon drejt Lozhës, në Bogishë, Depsyden, rreth Mora-jës, kalon në Cukal, sillet andej nga Liqeni i Ponarëve e në vijim drejt Qafës së Lugut të Thive, Lugut të Kaut, dirjet nga kodra e Gojfilave në Bishevë, ku fillojnë kufijtë më Margegajt....

Kjo zonë ka njohur e po njeh një zhvillim intensiv në tërë infrastrukturën e saj socialkulturore. Pikerisht, edhe për këtë fakt bujanasit ndjehen më të plotësuar e më krenarë se kurrë. Ashtu si para dhjetë viteve gjeneral Parllaku, si një enciklopedi e gjallë na rrëfente me detaje kontaktet e shumta me patriotë të kësaj zone në vitet e zjarra të Luftës Antifashiste Nacionalçirimitare, dhe më pas si kuadër i lartë i Ushtrisë.

E shprehu fare qartë këtë në bashkëbisedimin e ngrohtë e miqësor me deputetin e Kosovës, zonjën e nderuar Flora Brovina, e njohur si një aktiviste e hershme në fushën e të drejtave të njeriut dhe që vazhdimisht ka luftuar në emër të popullit të sa. Brovina, mjeke e shquar, poete e njohur, patriote e flaktë që përballoi me stoicizëm burgjet dhe dhunën barbare serbe, falënderoi nga zemra legjendën në kufirin e dy kohëve Parllaku për gjithçka ka bërë ai për Kosovën e për popullin e vet.

Pjesëmarrës në këtë Akademi përkujtimore të moderuar me mjeshtri të rallë artistike nga aktori nga Gjakova Betim Shehu; nënkyretari i OBVL Muharrem Cjoka-Mjeshtër i Madh dhe President i Ansamblit Artistik "Hazis Ndreu", Nderi i Kombit, mësuesja e talentuar Mimoza Kurti, veprimtare shembulllore dhe promovuese e denjë e historisë dhe vlerave arkeologjike e etonokulturore të kombit shqiptar edhe në SHBA ku jeton e punon prej vitesh, dhe veçanërisht poetja dhe humanistja e mirënjohura Bujana Malaj, bijë e denjë e kësaj krahine, ndjejnë krenari të ligjshme teksta fitet për Konferenën e Bujanit dhe historinë e laydime të Luftës Antifashiste të partizanëve kosovarë. Pjesëmarrës do të imprisionoheshin me recitim e poezisë që Bujana i kishte kushtuar kësaj konference gur themeli në historinë e Malësisë së Gjakovës.

Sic pohon vetë Bujana, autore e tre vëlimeve me poezi, frysëzimin për krijimin e kësaj poezie e kishte nga Rezoluta e Konferencës së Bujanit që ishte platformë dhe fitore e madhe e LANÇ, e cila nuk mund

të tjetërsohet, as të shlyhet me kurrrarë mjetesh institucionale, as jashtë institucionale edhe përfaktin se është arritur në Luftën e Dytë Botërore. Ajo flet me krenari për ata gra e burra, komunistë e nationalistë, atdhetarë e demokratë, përfaqësues të forcave të armatosura dhe të rinx antifashistë, që shënuan një gur themeli në të nesërmen dhe vizionin për të ardhmen e çështjes shqiptare.

Edhe në këtë akademi solemne në qytetin e Gjakovës, drejtues të Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës, dega Gjakovë e të Shoqatës së Intelektualëve "Jakova", nga Gjakova si organizatorë të saj, përfaqësues të OBVL të Shqipërisë, historianë e akademikë vlerësuan nisma të tilla për të kremluar përvjetorët ju-bilarë të ngjarjeve historike të kombit tonë.

Dhjetra pjesëmarrësit në këtë akademi solemne, ndër të cilët kryetari i OVLANC të Kosovës Lekë Hoxha, nënkyretari i kësaj organizate, gazetari dhe shkrimitari i mirënjohur Bashkim Hisari, kreu i degës së OVLANC Gjakovë Skënder Hoxha, Prof. Rushdi Sefa, kryetar i Shoqatës së intelektualëve "Jakova", Dr. Skënder Demalija – nip i komandantit të Brigadës së 5 partizane kosovare Shaban Haxhia, dr. Mehmet Rukiqi, Hasime Mertiri- mbesa e protagonistist të Konferencës së Bujanit Beqir Ndou dhe studjesi i historisë Mark Palnikaj vlerësuan mëndimin teorik e shkencor të referuesve në të, të bindur se do të arrihet njohja ndërkombëtare e pavarësisë së Kosovës nga të gjitha shtetet demokratike të botës dhe se Kosova do të zërë vendin e vet në Organizatën e Kombeve të Bashkuara e në organizatat e tjera ndërkombëtare, si shtet Sovran dhe i pavarur.

Në vigjilje të jubiluet të lavdishëm të 80-vjetorit të kësaj ngjarjeje madhore, kur aktualisht Tirana e Prishtina, por edhe Beograd dhe gjithë hapësira Juhindore e Evropës tentojnë Brukselin si kryeqytet të përbashkët dhe evropianizmin e demokracinë, si vlera gjithashtu të përbashkëta, jo vetëm organizatat e veteranëve e shoqatat e intelektualëve në Tiranë e Prishtinë, por parasëgjithash autoritetet shtetërore dhe vendore, duhet të organizojnë, jo vetëm akademi përkujtimore, por edhe Konferanca Shkencore ku të evidentojnë rëndësinë e Kuvendit të Bujanit, i cili ka vënë themelet e shtetësisë së Kosovës, si subjekt konstitutiv i shtetit të lirë dhe i pavarur.

# **REFERATI**

*Një ndër ngjarjet më të rëndësishme të historisë së re të Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi*

# **80 VJETORI - Konferenca e Bujanit gurthemel i shtetësisë së Kosovës**

**Dr.Alban Dobruna**

**K**onferenca e Bujanit është ndër ngjarjet më të rëndësishme të historisë së re të Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi, e cila, me vendimet largpamëse, do të bëhej pika referuese për gjeneratat e ardhshme dhe për çdo përpjekje për liri e pavarësi të popullit të Kosovës dhe shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Në këtë Konferencë u përcua zëri i popullit shumicë të Kosovës, e drejta përtiui bashkuar Shqipërisë, e jo Jugosllavisë. Konferenca e Bujanit u organizua me iniciativën e Shtabit Kryesor të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit të Ushtrisë Nacionalçirimitare të Kosovës, më 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944 në Kullën e patriotit Sali Mani, Bajraktarit të Krasniques. Në këtë Konferencë u mblohdhën delegatë nga të gjitha krahinat e Kosovës për ta ngritur atë në Konferencën e Parë Nacionalçirimitare, ndërsa me vota të përbashkëta zgjodhën Këshillin, Kryesinë dhe përpiluan rezolutën, që do të ishte platforma politike, e cila do të ndiqej nga populli shqiptar i Kosovës në luftë kundër pushtuesve deri në çlirimin e tyre me të drejtë e vetëvendosjes deri në shkëputje.

Ndër shtyllat e fuqishme të shtetit të ri në Kosovë mund të konsiderohet organizimi i Konferencës së Bujanit, pasi ajo u mbështetet në Karten e Atlantikut me të cilën garantohej vetëvendosja, pastaj Deklarata e Moskës, Rezoluta e Teheranit dhe Deklarata e Jaltës, ku thuhej: "Gjithkush në tokë të vet e gjithsejcili të vendosi mbi formën e qeveris së vetë". Pra, ky ishte parimi kryesor i aleatëve të mëdhenjë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore njëjeshja e radhëve antifashiste kombëtare dhe ndërkombe të ballkanike, evropiane dhe botërore, u bë mbi bazë të proklamimit dhe të garantimit e kësaj të drejtë për të të gjithë popujve pjesëmarrës në bllokun antifashist. Këtë të drejtë, në luftën antifashiste, në përpjesëtim të gjerë, falë kontributit vetjak, e siguroi edhe populli shqiptar në përgjithësinë dhe pjesa e këtij populli në Kosovë në veçanti, ndërsa kjo është konfirmuar me dokumentet historike të aprovuara në Konferencën e Bujanit. Pasi Lufta e Dytë Botërore zhvilloi parakushte për rishqyrtimin e problemit kombëtar të popullit shqiptar, i cili nuk ishte zgjidhur me krijimin e shtetit të pavarur shqiptar, e tërë Lëvizja Çlirimtare, që zhvillohej gjatë atyre viteve në Kosovë, ishte vazhdimi i përpjekjeve të pandërritura të popullit tonë për çlirim e bashkim kombëtar, këtë edëshmon mësëmiri Konferenca e Bujanit, e cila ishte pluraliste, ndonëse pjesëmarrësit në shumicën e tyre ishin komunistë, nuk mungonin as nationalistët, atdhetarët demokratë, përfaqësuesit e njësive të armatosura, të rinisë e të gruas antifashiste, të këshillave nacionalçlirimtarë. Përveç përfaqësuesve nga Kosova, në të morën pjesë delegatë nga treva e Plavës dhe e Gucisë, që u trajtuan si pjesë e pandarë e Kosovës, si dhe disa delegatë shqiptarë nga Malësia e Gjakovës, që vepronin në formacionet e atieshme partizane.

Populli shqiptar i Kosovës dhe i gjithë kombi ynë, asokohe po kalonte momente vendimtare historike. Ishte kjo koha kur miliona njerëz vdisnin nga makineria nazifashiste dhe fatet e popujve të vegjël lëkundeshin. Rreshtimi i shqiptarëve në këtë koalicion ka qenë një veprim i matur, ku merrnin pjesë patriotë nga të gjitha krahinat, besimet e orientimet. Ofensiva e re e vjeshtës në Lindje dhe marshimi i ushtrive anglo-amerikane në Jug, ishte sinjal i dështimit të politikave naziste. Alternativë e mundshme ishte bashkim i rreth Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Në të kundërtën, në qoftë se populli shqiptar do të ndiqte orientimin për të mos u angazhuar në këtë luftë me armë, apo, akoma më keq, për të bashkëpunuar me okupatorin nazifashist në masë të gjerë, do të kishte pasur pa dyshim pa-

- *Njëri nga bartësit kryesor të këtyre ideve në Bujan dhe nismëtar i orëve të para të punës konkrete ishte mësuesi nga Gjakova, Fadil Hoxha, komunist me bindje, më vonë një nga udhëheqësit kryesorë të Kosovës dhe një nga udhëheqësit më të lartë të Jugosllavisë Federative*



soja për vendin, ku shqiptarët në fund të luftës do të pësonin të gjitha pasojat e një vendi të mundur, aleat i boshtit fashist.

Lufta e popullit në Kosovë, në këtë periudhë, mund të thuhet se ishte unike me strategji e taktkikë të caktuar, që u zhvillua në kushte lokale specifike dhe të vështira, që nuk mund të zhvillohej shpejt dhe të organizonte luftë të armatosur në këtë truall. Në Kosovë, luftë përfshinte dhunën e ushtruar nga disa aktorë politikë. Për këtë arsy, çështja meriton një analizë të shumanshme, duke u fokusuar në ideologjinë, dhunën e ushtruar ndaj civilëve dhe dhunën luftarake midis dy ose më shumë fuqive ushtarake. Kjo vinte për shkak ndarjes së Kosovës në tri zona okupuese, politikës demagogjike të okupatorit, iluzionit të krijuar në një pjesë të popullit shqiptar në lidhje me çlirimin, si dhe disponimin antijugosllav për shkak të pozitës së vështirë në Jugosllavinë e periudhës ndërmjet dy luftërave botërore. Shqiptarët nuk e konsideronin humbje të shtetit të tyre kapitullimin e Jugosllavisë, ngase ata nuk gjëzonin të drejtat më elementare, e madje disa e konsideronin okupatorin edhe si çlirues. Kjo pozitë e shqiptarëve vinte për shkak të kundërtbërpicave nacionalë ma serbe malazëtarë.

kak të kundërthénieve nacionale me serbo-malazezët, nga frika e kthimit të së vjetrës, nga mosnjohja e kufijve të ndryshuar si rezultat i pushtimeve të shteteve fashiste, të cilat realisht për shqiptarët kishin bërë deri-diku një korrigjim të padrejtësive të së kaluarës dhe në fakt e kishin përmirësuar gjendjen e tyre në Kosovë etj., mandej nga prononcimi i mjegullt i Partisë Komuniste Jugosllave për të drejtën për vetëvendosje deri në shkëputje pas luftës, ndërkohe që shqiptarët kërkonin t'i pohohej qartë dhe menjëherë se do t'i u jepej mundësia të realizonin aspiratën e tyre për t'u bashkuar me shtetin shqiptar. Për më tepër hapat e PKJ-së në drejtim të kundërt, në favor të ruajtjes së Jugosllavisë në kufijtë e paraluftës (shih vendimet e Jajces, nëntor 1943) e deri te pengesat për zhvillimin e lëvizjes antifashiste në Kosovë eti, ishin elementë që


nuk mund të kapërceheshin lehtë nga kushdo. Andaj, për shkak të këtyre kushteve të ndërlikuara, gjatë Luftës së Dytë Botërore në Kosovë, Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare ndahet në dy fazë: Faza e parë (1941-1943) që ka të bëjë me formimin e organizatave antifashiste dhe të këshillave nacionalçlirimtarë si dhe përhapjen e luftës së armatosur, respektivisht me mënyrën e luftimit si pjesë e pandarë e Frontit Nacionalçlirimtar, deri në kapitullimin e Italisë (1943). Faza e dytë është periudha 1943-1945 e luftës në Kosovë, e zhvilluar shpejt, që në pikëpamje organizative mori trajtë të plotë, me çka pjesëmarrja e popullit në luftë u bë masive dhe u shpreh me aksione të llojullojshme për ndezjen e luftës dhe zgjerimin e madh të saj.

Organizimi i Konferencës së Bujanit ishte një domosdoshmëri e kushtëzuar nga nevojë për t'i bindur masat shqiptare me një akt të besueshëm ashtu që të mobilizohen në luftë kundër fashizmit. Pra, për t'i frymëzuar ata që me të drejtë nuk i besonin ardhmërisë së pas luftës, arritin të bindnin një pjesë të popullit për angazhimin aktiv në këtë luftë, duke projektuar bindshëm vizion e së ardhmes. Kjo Konferencë shpreh edhe vetë karakterin dhe specifikën e lindjes dhe të zhvillimit të lëvizjes çlirimtare në Kosovë, lëvizje që përherë tentoi të jetë objektivisht e pavarur. Rezoluta e Bujanit ka qenë akti i parë legislativ i përfaqësuesve të popujve të Kosovës që ka synuar pavarësinë e Kosovës në bazë të së drejtës për vetëvendosje. Kjo Konferencë ka rëndësi të madhe historike, pasi shpreh hapur që në fillim bashkërendimin me aleatët e koalicionit antifashistë në botë. Prandaj, pos karakterit kombëtar, kishte edhe karakter ndërkombëtar, sepse me praninë e përfaqësuesve aleatë dhe me garancitë e tyre çështja e Kosovës u ngrit në arenën ndërkombëtare, duke mbrojtur me vendosmëri edhe të drejtën e vetëvendosjes së popullit shqiptar.

Organizatorët e Konferencës së Bujanit, sa i përket

(Vijon nö fagen 10)

## PORTRETE

**Nga Xhavit LASHI****Anëtar i Kryesisë së OKDA**

**N**ga pjesëmarrësit në Konferencën e Bujanit pati edhe dëshmorë që derdhën gjakun për çlirimin e atdheut si Hajdar Dushi, Xhevded Doda, Xheladin Hana, Jah Salih Mani, Tefik Çanga etj.

**Heroi i Popullit Hajdar Dushi**

Lindi me 18 shkurt 1916 në Prishtinë. Më vonë familja e tij u kthye në Gjakovë prej nga ku kishte prejardhjen. Nisi shkollimin fillor në Prishtinë dhe i vijoj mësimet në Medresenë e Shkupit. La mësimet në Shkup dhe erdhë në Shqipëri, ku ndoqi dhe përfundoi arsimin e mesëm në Gjimnazin e Shkodrës. Qe pjesë e celulave komuniste, që kishin nisur dhe zhvillonin veprimtarinë e tyre në atë gjimnaz së bashku me Emin Durakun, Haki Tahën e Lazer Radin Hajdar Dushi ka qenë antar i grupit komunist të Shkodrës.

Në kohën e okupimit fashist, Hajdar Dushi konsiderohej nga okupatorët si propagandues i ideve të rrezikshme në Durrës, Vlorë, Berat, Elbasan dhe Korçë. Ai ishte prijës i demonstratave të prillit 1942 në Durrës. Ishte njohës i mirë i disa gjuhëve të huaja; Anglisht, Italisht, Gjermanisht e Turqisht. Hajdar Dushi ishte ndër të parët që përktheu pjesë të "Kapitalit" të Marksit në shqip. Ka përkthyer dhe libra me karakter të lëvizjes antifashiste, për shkak të cilave u arrestua dhe pas 9 muajsh iku nga burgu.

Hajdar Dushi ishte antar i Partisë Komuniste Shqipëtare që me themelin e saj me 8 nëntor 1941. Ai ishte përgjegjës i celulës së Grupit Komunist të Shkodrës në qytetin e Durrësit. Në mbledhjen e parë për Qarkorin e Durrësit, Hajdar Dushi u zgjodh sekretar organizativ. Qarkori "PKSH" Durrës mbulonte Durrësin, Matin, Myzeqenë.

Hajdar Dushi ka qenë pjesëmarrës i mbledhjes Bujanit dhe ishte një ndër formuluesit e Rezolutës Konferencës. Ai u dërgua nga PKSH për të ndihmuar për organizimin dhe zgjerimine mëtejshëm të lëvizjes nacional çlirimtare edhe ne Kosovë. Hajdar Dushi u vra pabesishët në moshën 28 vjeçare më 24 shtator 1944, nga forcat që ishin kundër lëvizjes në afërsi të Kalasë Dodës,

**Xhevdet Doda**

Lindi në Prizren në vitin 1906. Familja e tij është shpërndarë herët në shtetin Shqipëtar. Pasi kreua shkollën Normale të Elbasanit, punoi mësues në Tiranë, Korçë, Krujë, Milot e Durrës. Xhevdet Doda që në moshë

# Dëshmorët pjesëmarrës në Konferencën e Bujanit



të re, u shqua për ndjenjat e tij atdhetare e patriotike.

Në zgjedhjet bashkiake të Korçës me 1936, me mbështetjen e grupit komunist të Korçës u zgjodh këshilltar i bashkisë.

Pas pushtimit fashist, Xhevdet Doda u hodh në lëvizjen Antifashiste NA-ÇL. Për të ndihmuar zhvillimin e Lëvizjes Antifashiste NA-ÇL në Kosovë u kthye në qytetin e lindjes në Prizren, duke u bërë një nga luftëtarët më aktiv. U arrestua dhe u internua në Kampin e Porto-Romanos në vitin 1943. Pas arratisjes nga kampi, u muan me organizimin e forcave partizane në Kosovë. U caktua komendant batalioni dhe më pas me krijimin e Brigadës Parë Kosovare-Maqedonase u emrua zëvendës komendant i saj. Xhevdet Doda luftoi me të gjitha energjitet për të ngritur popullin e Kosovës në luftë kundër pushtuesve të huaj e bashkëpunëtorëve të tyre.

Ishte një nga protagonistët kryesorë i Konferencës Bujanit 31 dhjetor - 21 janar 1944. Në këtë mbledhje Xhevdet Doda u zgjodh anëtar i Kryesisë Këshillit Krahinor të Kosovës dhe Rrafshit Dukagjinit.

U arrestua tradhëtisht në Prizren në shtator 1944, duke qenë i sëmurë rëndë dhe u dërgua në kampin e përqëndrimit në Mathauzen ku u pushkatua në pranverën e vitit 1945.

**Xheladin Shyqyri Hana**

Lindi në Gjakovë. Kreu Gjimnazin e Shkodrës dhe Normalen e Elbasanit. Veprimtar i lëvizjes për çlirimin e Kosovës, mësues e gazetar. Si gjithë të rinjtë edhe Xheladini kishte si qëllim mbrojtjen e trojeve Shqipëtare dhe bashkimin e popullit Shqipëtar në një

shtet të vetëm. Xheladin Hana mori pjesë në lëvizjen demokratike të rinisë Shqipëtare dhe u bë anëtar i grupit komunist të Shkodrës. Në vitin 1941 u dërgua në Kosovë si mësues në Elshan e në Kijeve dhe u ngarkua nga P.K.SH për të ndihmuar në zhvillimin e Lëvizjen Antifashiste N.A.Ç.L. Në vitin 1942 u burgos në Prizren. Pas lirimit nga burgu mori pjesë në njësitin partisan Bajram Curri, që vepronit në Malësinë e Gjakovës.

Xheladin Hanën, e gjemjë të angazhuar në krahun e bashkimit të forcave shqipëtare. Si antar i kësaj lëvizje ai merr pjesë në Konferencën e Bujanit, ku është bashkëautor i dokumentave që dolën nga kjo konferencë. Pas çlirimt punoi gazetar në Radio, mësues në Gjimnazin e Prishtinës e në vazhdim drejtor i gazetës Rilindja. Me 13 dhjetor 1948 u vra nga UDB Jugosllave.

Aktiviste e Luftës NA.ÇL ishte dhe motra e tij Hyrije Hana e lindur në qytetin e Gjakovës më 10 mars 1929. Ajo ishte pjestare e bataljonit partizan "Bajram Curri".

**Jaho Salih Mani**

Lindi më 21 prill 1921 në Fshatin Bujan të Malësisë Gjakovës. Familja e Mulosmanëve të Krasniqes është familje e njohur për tradita patriotike. Nga kjo familje e çerdhe liridashëse dolën shumë figura të shquara. Nga këta mund të përmendim Mic Sokoli, Man Avdija, Shaban Binaku, Binak Alia, Zeqir Halili, Bajram Mani, Sali Mani, Rexhep Abdullahi, Avdi Bajrami, Mehmet e Idriz Mulosmani, Rustem Avdyli, Jah Salihu.

Pas mbarimit shkëlqyeshëm të shkollës fillore në Internearin Koso-

va në Krumë, vazhdojë Gjimnazin e Shkodrës. Atje kreua dy klasë ku do të shquhej jo vetëm si nxanës i mirë, por edhe përvitytet e tij të larta. I ndjekur nga rregjimi dhe policia e Shkodrës, vitin e tretë do ta vazhdoj në Tiranë. Policia e kishte vënë nën kontroll edhe në qytetin e Tiranës. I detyruar vitin e fundit do ta vazhdonte në Korçë.

Në vitin 1940-41 Jah Salih do të rregjistrohej e do të vazhdonte studimet në Universitetin e Padovës në Itali. Për ide e mendime përparimtare do të kthehej në vendlindje. Në vitin 1942 e gjemjë kryetar komune në Vlashnje të Prizrenit.

Nga tetori 1943 angazhohet me lëvizjen guerile e partizane në krahinën e Malësisë së Gjakovës.

Në vitet në vazhdim Jah Salih Mani do të shquhej si organizator dhe në luftëtar i paepur për çlirimin e vendit. Për këtë u zgjodh nënqryetar i Këshillit NA.ÇL të Krasniqës.

Me 27 nëntor 1943 u bë mbledhja e rinisë në Tpla, ku u themelua batalioni "Rinia" me komandat Jah Salih. Ai me 25 gusht 1943 kishte përshendetur në Beslidhjen e Malësisë Gjakovës te Ura e Kolgecaj.

Jah Salihu që një prej organizatorëve dhe mbrojtësve me jetë të Konferencës Bujanit dhe një gardian i flaktë për mbrojtjen e vendimeve të kësaj konference. Me 14 Shkurt 1944 në Rranzat e Grisë, forcat gjermane vranë 11 vetë dhe komandantin Jah Salih Mani.

I jati Jahës, Sali Mani, me marrjen e informacionit për vrasjen e djalit të tij tha :

"Burrat vdesin për liri." Brezat që do të vijnë, do të mësojnë se prej kullës Jah Salihit, zë fill pavarësia e Kosovës.

**HISTORIA****SESIONI I PARË SHKENCOR PËR TOPONIMET – Kabash Qender, 21 Maj 1977****Profesor EQEREM ÇABEJ NË KABASH TË PUKËS****• PROF. E. ÇABEJ, AKADEMİK..**

“Është hera e parë që në Republikën tonë mbahet një sesion shkencor me këtë tematikë, prandaj Kabashi me këtë iniciativë fisnike ka marrë bajrakun më dorë ....”!

**• Prof. M. DOMI, Akademik:**

“Më lejoni t’i sjellë këtij Sesioni Shkencor përshtenjet më të zjarra të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë dhe të Akademisë së Shkencave! përgëzimet e tyre shkollës 8-vjeçare të Kabashit... për ndërrmarjen dhe organizimin e këtij Sesioni Shkencor” !

**Xhemal MEÇI**  
**Studiues, “Mjeshtër i Madh”**

**SESIONI SHKENCOR PËR  
TOPONIMET - VLERËSIMË DHE  
OPINIONE**

**ATSH, 25 maj 1977** – “Këto ditë organizohet në shkollën 8 – vjeçare të fshatit Kabash një Sesion Shkencor kushtuar rolit edukativ e shkencor të toponeimeve të vendlindjes. Në këtë Sesion, që është i pari i këtij lloji i organizuar në vendin tonë, morën pjesë edhe shkencetarë të Institutit të Gjuhësisë e të letërsisë të Akademisë së Shkencave të RPSSh. Pjesëmarrësit dëgjuan me interesumtesat.”

**Gazeta “MËSUESI”,** (Tiranë, më 25 maj 1977): “Sesioni Shkencor në fshatin Kabash tregoi se kur puna organizohet mirë arrihen edhe rezultate të mira në masivizimin dhe zgjerimin e punës shkencore në fshat, ku militon një pjesë e madhe mësuesish. Ky Sesion pati vlerë,... jo vetë për të njohtur prejardhjen, por edhe kushtet historiko - shqërore të Toponeimeve vyr... por... dhe pasuroi historikun e fshatit, por edhe të rrethit Pukë e më gjërë....”

**Gazeta “ZËRI I POPULLIT”,** (Tiranë, më 30 maj 1977) “Shoqata e mësuesve të historisë rrethit të Pukës u ka kushtuar kujdes të veçantë mbledhjes dhe studimit të toponeimeve, llll që kanë sjellë vlera të veçanta për edukimin patriotik e revolucionar ... të brezit tonë të ri....”

**REVISTA “STUDIME FILOLOGJIKE”** (Tiranë, Nr 3, 1977 e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, ASH RPSSH) : “në Kabash të Pukës u mbajt një Sesion Shkencor për Toponiminë nga Shkolla 8 – vjeçare .Kabash me rëndësi edhe në plan kombëtar....”

**Prof. J. KASTRATI,** (letër , Shkodër, 7 shtator 1977)? “I dashur Xhemal, Prof. E. Çabej, prof. M. Domi dhe unë kemi mbetur shumë të kënaqur nga organizimi i mirë i Sesonit Shkencor nga tematika e pasur, si dhe nga pritja shumë e ngrohtë, e përzemërt e plot respekt! Ju përgëzoj për suksesin e merituar që arritët me Sesonin Shkencor për Toponimet në Kabash.”


**Prof. Aleks BUDA,** Kryetar i Akademisë së Shkencave të RPSSH. ( Letër , Tiranë, më 17 shtator 1978): “I dashur shoku Xhemal, Ju përgëzoj që po e bëni Kabashin modest dhe shkollën e tij një qendër nisiativash të tilla të mira dhe mirë kanë bërë dhe shokët e mij E. Çabej dhe M. Domi që kanë vlerësuar punën tuaj edhe me pjesëmarrjen e vet...”

**• ANASTAS KONDO, ZV/MINISTËR I ARSIMIT DHE KULTURËS:**

“Falënderojmë nga ana jonë si Ministri për këtë Sesion Shkencor të Shkollës 8 – vjeçare të Kabashit në bashkëpunim me Kabinetin Pedagogjik të Pukës, shokët e Akademisë, Prof. E. ÇABEJ, Prof. M. DOMI, Docent J. KASTRATI dhe (studiuesin, sot Akademik) Gjovalin SHKURTAJN për këtë aprim që bënë për këtë ballafaqim të mendimit shkencor në gjirin e masave së bashku me arsimtarët tanë.”

**• DOCENT J. KASTRATI:**

“Është kënaqësi e veçantë përmua që në emër të Këshillit Shkencor të Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës dhe të Katedrës së Gjuhës Shqipe të këtij Institucioni t’i sjellë përshtendetjet dhe urimet më të mira Sesonit të parë shkencor në vendin tonë për Toponimet, që është një kontribut i vyer në Mendimet tona Albanologjike!.....”

**NISMA**

Këtë vendim e kërkoi Drejtori i shkollës me përkrahjen e mësuesit vizionar Ramadan Islami që të pengohet ndonjë ndërhyrje partiale hakmarrëse, ambicioze përmes nxjerr pengesa, gjë që u bë fakt në fazën përfundimtare të përgaditjes me kumtesa, ftesa drejtuar të gjithë mësuesve të lëndës gjuhë-letërsi, drejtoreve të shkollave e tjerë, kur që Sekretari i aparatit të Komitetit të Partisë së Rrethit Pukë, Nd. V., pretendues se vetëm ai mund të mdërmerrte nisma përmes shkencore në Rreth, me që na Paska kry kryer shkollën e Lartë të Partisë në Tiranë (por, ama me shkollë të mesme pedagogjike me bazë fillore), i cili porosit sekretarin e Byros së fshatit të Bashkuar që të bëhet maledha e organizatës - bazë të Partisë dhe të hijet mësuesi Xh. Meçi nga programi, “sepse nuk e transferuan në Kabash me sjellë atje akademikët përmë sesion shkencor me përmasa kaq të gjëra!”. Mirëpo ndërhyrja e të ndjerit Halit Selimi ishte vendimtare, i cili kundërshtoi që të veprohet kështu, duke thënë: “Le të vijë vet Nd. V. dhe ta drejtoi mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë të Kabashit! Si mund të largohet ai që është marrë me përgaditjen e këtij sesioni shkencor. Për më tepër ai me kërkosën e Komitetit të Partisë dhe të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit ka përgaditë Historikun e Rrethit Pukë bashkë me studiusin Mark Kovaçi, Major në Ministrinë e Mbrojtjes! Në vazhdim e përbylli HISTORIKUN e RRETHIT me një sesion shkencor për “Traditat Patriotike e Revolucionare”, ku mori pjesë vet kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Qamil Morina, dhe pati aq sukses sa edhe u botua menjëherë në gazetën e përditëshme qendrore “BASHKIMI”, f.2. Dhe siç e dini nuk vunuani përgëzimet nga vetë Komiteti Qendror i Partisë dërguar Dedë Gjergjiti. Prandaj unë kërkoi që kjo ndërhyrje ambicioze të mos pranohet!” Dhe ashutu u bë. Mësuesit iu përveshën punës me kabinete mësimore dhe këndet në oborin e shkollës, ku dallohej Këndi Gjeografik i përgaditur nga mësuesi i dalluar Musa Hoxha.

Sekretari i Parë i Partisë së Rrethit dhe anëtar i Byros Politike të KQPPSH, i ndjeri Pali Miska, në dijeni nga Dedë Gjergjji, Sekretar i Prisë Rrethit që jetonte Propagandën e Partisë në Rreth si edhe arsimin, porosi vet Ngrecë Vatën dhe Shefin e Arsimit të Rrethit, Pashk Leka që të merreshin seriozisht me Kabashin për pritjen dinjitoze të Akademikëve të nderuar me të cilët do të vijë edhe Anastas Konda, Zv. Ministri i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, Anëtar i

Komititetit Qendror të PPSH, një ndër dhe vlerësim për Pukën. (Pali Miska e ka dashur dhe përkrahur dh njerëzit e aftë e të punës, ndër të cilët isha edhe unë), që Puka, kur i ka mundësitet, të mos mbetej mbas rretheve të tjera. Por edhe Puka e kujton edhe sot me respekt me faljet më të mira.)

Prof. J. Kastrati na porositi: “Do të ishte gjë me rëndësi e vlerësim për ju, në se i shumëfishoni kumtesat për panelin, sepse kjo punë bëhej vetëm për raste konferencash apo kongrese Komëtare e Ndërkombëtare! Këtë detyrë e mori përsipëri vetë Drejtori i Kabinetit Pedagogjik, i ndjeri Sylë Bejtja, i cili e realizoi me Shaptilografin e Komitetit Ekzekutiv të Rrethit me anë të Hajrush Durrës, që e kishte në ngarkim. Kështu kumtesat e Kabashit në 10 kopje ishin gati ditën e Sesonit sShkencor dhe ia vuamë përpëra panelit drejtues duke u thënë: “Këtu në dosje secili prej jush i keni kumtesat e mësuesve të Kabashit. Prof. Çabej buzëqeshi duke thënë: “Bravo! Kjo tregon për një përgaditje tuajën serioze!” Kumtesën e parë e referoi Prof. E. ÇABEJ: “Prejardhja e topomin PUKË, ku shpjegoi se emri i parë i fshatit Grykë- Gominë fillimisht quhej PUKË, nga Via Publika, Publika. PUKË. Kurse në Mesjetën e Herëshme quhej SHPAL, nga Manastiri i Shën Palit; ndërsa emrin e sotëm KABASH e ka marrë nga fillimi i mesit të Shek. XVII. Të pranishmit, auditori e ndoqi me vëmendje, si edhe të gjitha kumtesat e tjera: Prof. M. DOMI – kumtoi “Mbi çështjen e prejardhjes të disa toponeimeve të Huaja”; Prof. J. KASTRATI – Jenorim de Rada për Toponimin e historike shqiptare”; Gj. Shkurtaj “Probleme teorike dhe metodike të studimit të toponimisë”. Gjithashtu u mbajtën edhe kumtesat e mësuesve të shkollës Kabash, kurse “Vështrimi mbi toponimet e fshatit Kryezi të Pukës” e kumtoi Agim Caushlli.

Fotot e Sesonit Shkencor i realizoi mjat mirë Mustaf Beqiri, që nga paneli (A. Kondo, prof. M. Domi, P. Leka, Prof. E. Çabej, ND. Vata dhe doc. J. Kastrati), me auditorin brenda në sallë dhe në natyre deri te biseda e prof. Çabejt me Xh. Meçin etj. Me drekën karakteristike kabashisht u muar Elez Lluka, Shefi i Llogarisë së kooperativës; kurse Ferit Lusha solli qershitë e para bojli.

Për “Toponimin KABASH” prof. E. ÇABEJ u shpreh kështu në letrën e Tij (Tiranë, 5 qershor 1977): “Kumtesën tuej mbasi e dëgjova në Kabash, e lexova edhe këtu (në Tiranë). E gjej një kontribut të vlefshëm në fushën e toponomastikës shqiptare...”. Ndërsa Prof. J. KASTRATI thikon se “Toponimi Kabash, Pukë (13 faqe të daktilografuara) më pelqej, Punimi është me interes shkencor dhe një kontribut i vyer në këtë drejtim.. Ai sjellë elemente të reja të panjohura ose pak të njohur.” (Letër, Shkodër, 7 qershor 1977),

**SHËNIM:** Të gjitha kumtesat bashkë me përshtendetjet dhe vlerësimt u botuan të plota te almanaku “PUKA DHE SHKOLLA” (Nr 3, Shkodër, 1977). Prof. Çabej një kopje ia dërgoi Prof. Gjerman, albanologut CLAUS HAEBLER.


**pjesëmarrës**

## OPINION

# RISHKRIMI I HISTORISË TI SHËRBEJË BASHKIMIT DHE JO PËRÇARJES SË SHQIPTARËVE

**SHPENDI TOPOLLAJ**

Kushdo e ka të qartë se shtrembërimi i historisë së një populli, sjell pasoja mjaft të rënda për të sotmen dhe të ardhmen e tij. Askund tjetër më shumë se në Shqipërinë e kohës së diktaturës nuk u zbatua konstatimi i Stefan Cvajgut se "Historia lavdëron vetëm ata që u buzëqesh suksesi". Fitimtarët e pas Luftës së Dytë te ne, krahas të vërtetave të padiskutueshme, ku ata kishin luajtur një rol mjaft të rëndësishëm, herë pas here, si me qëndrimin zyrtar, si me fjalimet e udhëheqësve kryesorë, me shkrimet e tyre, apo orientimet që jepnin, i dhanë përpilimit të historisë fytyrën që deshën vetë, duke e korrektuar atë sa herë zbulonin "armiq e grupe armiqësore", pra jo vetëm duke denigruar, përcuar e akuzuar kundërshtarët politikë, por edhe duke na lënë trashëgim një sherrnajë e përçarje që po e vuajmë edhe sot e kësaj dite. Nuk ka vend në Evropë, për të mos shkuar më tej, ku mospajtimet dhe ndarjet të jenë po ato të 80 viteve më parë, sic po ngjet në Shqipëri. Në realitetet e reja që solli demokracia e pas nëntëdhjetës, është mëse e domosdoshme që të rishkruhet historia e vërtetë, pa pasione politike e hakmarrëse, dhe që i shërben bashkimit tonë. Natyrisht që kjo nuk është një punë aq e lehtë për të mbërritur deri tek ajo që gjenia e Napoleon Bonapartit e formulonte kështu: "Historia është versioni i ngjarjeve të shkuara, për të cilat njerëzit kanë vendosur të bien dakord". Thashë që nuk është e lehtë, pasi edhe për vetë "babain e historisë", Herodotin, Straboni thosh se "në shkrimet e tij ka shumë marrëzira" dhe Ciceroni shihte atje "shumë përralla të pabesueshme". Po fundja, ashtu si historitë e të gjitha vendeve të tjera, ku ndodhitë e vjetra nuk mund të ndahen edhe nga mitet e legjendat, edhe neve nuk na prish ndonjë punë të madhe fakti që Skënderbeu ishte i gjatë apo i shkurtër, e ndante kalin më dysh me një të rënë të shpatës apo jo. Ne, të keqen kryesore i kemi te trajtimi i këtij shekullit të fundit, me ngjarje mjaft intensive dhe ngatërresa të pafundme, ku mendimet dhe bindjet për to dhe protagonist kryesorë, ndryshojnë sipas interesave dhe krahëve politikë që



historianët, pse jo edhe intelektualët, përfaqsojnë. Nuk ka dyshim se shumë nga autorët e teksteve të historisë, pra ata që i certifikuan qëndrimet ideologjike të partisë - shtet, jo vetëm që nuk mund të fajesoher për sa ngjau, por edhe i kanë kapacitetet profesionale dhe kulturën për të vijuar kontributin e tyre në hartimin e historisë. Megjithatë, do të ishte e padrejtë që këtë detyrë kaq serioze sot, ta udhëhiqin po ata. Është e pamundur të mohosh gjithësa ke shkruar deri sa ra komunizmi dhe këtë e them me fakte: Dëgjoja një profesor, historian dhe politikan të nderuar, gjatë një interviste televizive. Atij i qe ngarkuar detyra, natyrisht me të tjerë, të merrej me rishkrinin e historisë. Etika nuk më lejon t'i përmend emrin, por ai shquhet përdije dhe vtpërbajtje dhe gjëzon respekt tek ata që e dëgjojnë. Por shihni si përgjigje afersisht, kur e pyeste moderatori: - Cili është roli i Esat Pashës? - Më i ligu në gjithë historinë tonë, i vulosur si tradhtari më i madh i interesave të Shqipërisë, se ai pas bisedave me princin Danillo, e dorëzoj Shkodrën me protokollin e 23 prillit 1913, kur anijet e fuqive të mëdha që do ta ndihmonin, ishin ankoruar në det dhe dukeshin që nga kalaja. Pastaj, la të kuptohej se edhe Hasan Riza Pashën që e kishte thirrur për darkë, e vrua duke dalë nga dera e shtëpisë së tij. Ishte karrierist dhe donte të bëhej sundimtar i Shqipërisë etj. Unë tek e dëgjoja pyesja veten se a i ka lexuar ky dëshmitë e nëpunësit të Konsullatës italiane në Shkodër Gino Berri dhe sidomos kujtimet e Hortensës, gruas së konsullit të Austro - Hungarisë, dëshmitare autentike e atyre ngjarjeve e cila pohon krejt të kundërtën, duke theksuar se Esati bëri gjithçka në mbrojtje të qytetit që bombardohej rreptë nga serbo - malazezët, ku njerëzit përmuaj me radhë, vdisnin si mizat dhe uria i detyronte të hanin minj. Ajo citon fjalët nga më atdhetaret

që Esati u tha ushtarëve, parisë dhe hierarkëve të fesë, para se me rregull, flamurë, armë e llogistikë të largoheshin nga Shkodra; pra, se do të ktheheshin përsëri, se Shkodra ishte e Shqipërisë, se aty kishin varret e të parëve të tyre, pasi princi malazez hi-pur mbi kalin e bardhë, i kishte thënë se ti po ikën me nder dhe jo i mundur. Profesori, patjetër që i kishte lexuar ato para meje, por sikur donte t'i anashkalonte. Ndofta, te figura e Esatit, për veprimet karrieriste të tij, ka së duash vend për qortime, por kjo nuk do të thotë që të mohohet gjithçka qysh nga lindja. Pastaj, moderatori e pyeti për Ahmet Zogun. Profesori nuk mohoi shumë nga vlerat e tij si burrështeti, por shtoi se ai ka gabuar në periudha të caktuara, duke harruar prishjen përfundimtare me përkrahësit jugosllavë në vitin 1926 pas shtypjes së nxitur nga ata dhe që mori emrin "Kryengritja e Dukagjinit" apo duke e fajësuar atë me nënkuptim për traktatet e 27 nëntorit 1927 dhe atij të pas një viti me Italinë që pasoi me krijimin e Bankës Kombëtare, të Shoqërisë për Zhvillim Ekonomik etj. Po të shihet rapporti i ambasadorit të asaj kohe të SHBA Herman Bernstein, drejtuar Sekretarit të Shtetit do të vësh re qëndrimin burrror, të qartë dhe plotësisht në favor të Shqipërisë dhe paravësisë së saj nga ana e Ahmet Zogut. Madje ai shkon më tej duke e cituar atë: "Unë kam në kabinetin e tashmë dy vetë, të cilët ishin kundërshtarët e mi, armiq të mi. I kam marrë në kabinetin tim, sepse besoj se ata mund të jenë të aftë t'i bëjnë shërbim të mirë shtetit. Po përpinqem me gjithçka që kam të bëj të pamundurën, që të shfrytëzoj të gjitha forcat më të mira të aftësisë njerëzore në të mirë të shtetit". A nuk të kujton ky gjest i rrallë atë që në përshkrimin e Patrik Ravinjanit, bëri Napoleoni me dy ministrat e tij, respektivisht ministrin e brendshëm, Fushën dhe të jashtëm, Talejanin,

që ishin kundërshtarët e betuar të tij? Duke e quajtur mbretin vizionar të zgjuar, ambasadori shton fjalët që ai i tha: "Propozimi i Brianit për një formacion të një bashkimi shtetesh europiane, vështirë se mund të merret si çështje serioze. Për një kohë të gjatë kjo do të mbetet veçse një èndërr, një ideal i largët, një gjest fisnik i Francës, për të impresionuar botën, sikur ajo po punon për paqen. Unë nuk besoj në seriozitetin e atij propozimi të bërë nga një vend, i cili është duke ndërtuar anije luftarakë dhe duke i rritur forcat e armatosura, ndërkohë që i fton vendet europiane të bëjnë një Bashkim Federalist për të ruajtur paqen". Dhe duke vazhduar më tej me fajet e mbretit, profesori u kujtua për eliminimin fizik të kundërshtarëve të tij, duke mos marrë parasysh sa pohon Sejfi Vllamasë që kishte marrë pjesë në atentatin që i bënë atje në Vjenë teksha dilte nga opera, i cili thotë se të gjithë ne politikanët shqiptarë të asaj kohe, atë mënyrë sjelljeje kishim me ata që i konsideronim kundërshtarë. Iku mbreti më 7 prill të 1939, po kush nga mbretërit e Evropës nuk iku, kur si Italia fashiste na sulmoi neve, ju turr Hitleri vendeve të tyre me armatën e tij? Po i burgosuri politik në kohën e monarkisë, shkrimtari Haki Stërmilli e keni lexuar se ç'thotë për të te libri i tij "Burgu"? I thashë të gjitha këto, jo se jam ndonjë simpatizant i monarkisë, por duke qenë ndjekës i të vërtetës historike, kam dyshimin se a do të mund të dalin ata që e shkruan dikur historinë, nga guacka e portretizimeve të dikurshme. Do kurajë dhe ndershmëri të madhe kjo. Por le të vazhdojmë me deklarimet e profesorit, kur moderatori e pyeti nëse Enver Hoxha ka vepruar ndonjëherë në dëm të interesave të Shqipërisë? Edhe Enver Hoxha, shqiptar ishte. Në historinë tonë patjetër që zë një vend të veçantë si në luftën nacional - çlirimtare, ku

## REPORTAZH

# Gjethë kujtimesh të Dritero Agollit në Kryezi të Pukës

**Sefer Pasha**

Q ysh nga Ura e Bardhetit udhën e bëjmë në këmbë nëpër Luginën e lumbit të Kryeziut. Mua më shoqeron biri i këtij fshati, intelektuali Bilbil Dervishi. Do të shkojmë dhe tek kullat e atit të tij, Nuhut. Trashgimtarët, përfshi dhe djalin e madh Shkelzenin, i cili banon në Amerikë po investojnë që banesa e të parëve pas rikostruksionit të kthehet në një vilë për turistët që kanë filluar të vijnë në Kryezi nga e gjithë botë. Kulla e qëmotëshme është ndërtuar në krye të Arës së Epërme. Mbi të është Qafa e Benës, kurse përballë të mahnitë Kunorë Dardha.

Udha në këmbë anës lumbit që gurgullon e shpërndan tinguj çiftelje. Shoqëruesi, miku im Bilbil Dervishi nuk e pranon mendimin tim se Avni Rustemi e ka vizituar Kryeziun. E kam dëgjuar qysh fëmi më thotë ai. Por nuk ka asnjë dokument që ta vërtetojë atë që thuhet gojarish se Avni Rustemi ka qenë në Kryezi. Unë përpinqem që t'i mbush mendjen. Kur isha në Gjirokastër historjani Lefter Dilo e që ishte biograf i Avni Rustemit dhe kishte botuar disa libra për të më thoshte se deputeti i Lumës Avni Rustemi ka qenë dhe në Kryezi të Pukës. E kam besuar atë që më ka thënë Lefter Dilo në Gjirokastër. Trimi Avni Rustemi ishte njeri erudit. Qe e pamundur që të mos e viziton te Kryeziun e cila ishte vendlindja e Shtjetëfën Gjeçovit. Gjithsesi anës së lumbit fantazoj. Natyrish që Avni Rustemi është futur në luginën e Kryeziut që nga Ura e Bardhetit. Po përsë e vizitoj Kryeziun? Cilat ishin interesat e tij politike? Nuk e nxjer dot mendimin mbi majën e Kunorë Dardhës. Në jug të vendit këndohet labërisht: /Djal i popullit o Avnil/.

E kështu çap pa çapi në udhën e asfaltuar për bukurime bashkudhëtarin rrëshim mendime. Me Moikom Zegon patëm ardhur në Pukë dhe në Kryezi disa herë. Unë me aparatin fotografik i kam berë shumë foto sidomos në udhëtimin e fundit kur ai u godit nga leuçemia. Po përgatis të batoj dhe një album me fotot magjepse. I thoja Moikomit siç më kishin thënë se Migjeni kishte shkuar në Kryezi. Moikomi më kundërshtonte. Unë jam botues i Migjenit më thoshte ai. Jo! Migjeni nuk ka qnë kurrë në Kryezi. Ai ishte në siklet të madh për arsyet e njohura shëndetësore. Që Migjeni të vinte nga Puka në Kryezi në kushtet kur nuk kishte as rrugë dhe as mjete kjo ishte një skarifëcë e madhe. Poeti i madh kombëtar ishte me turbukuloz. Ai edhe kur shkonte në restoran në Pukë i merrte pjatat dhe lugët me vete që të mos infektonte të tjerët. Prandaj është e paimagjuneshme që Migjeni të merrte udhën nga Puka për në Kryezin e skajshëm. Këto mendime ja them dhe mikut tim, i cili më shoqeron në këtë udhëtim për në fshatin e tij të lindjes. Ai qesh dhe më tegon për një pukjan që ka humor të hollë. Ai në një rast u kishte thënë miçëve nga Kryeziu: - Pa shikoni se mos i gjeni ndonjë "RRANJË" dhe Migjenit në Kryezi! Humoristi e kishte fjalën se kryeziasit e reklamonin më shumë se ç'duhej fshatin e tyre. I veshin dhe ca meritë që nuk i ka. E bëjnë Paris.

Në bllokun e shënimive ku hedh ndnjë motiv më kujtohen qortimet e mikut tim poetit dhe studjuesit erudit Moikom Zegos. Ai më thoshte mos thuaj Shtjetëfën Gjeçovi se emri i vërtetë është Mëhill Kostandin Gjeci - Kryeziu. Kështu më porosiste Moikomi ta shkruash kur përcjell materiale për këtë fenomen të Kryeziut të cilin e vranë serbët në Zym të Kosovës në vitin 1929. Ti Sefer nëpërt libra thua të njëjtat gjëra. Zogjtë e Kryeziut kanë mbjellë qershët e Gjakovës nëpërmjet bërrhamave që i marin me sqep. Por për Gjeçovin në Kryezi dhe sidomos në Janevë të Kosovës qarkullon mendimi se një libër i Gjeçovit dhe pikërisht ai me titull: "Princi i Dibrave" gjendet në një familje në Kryezi. Libri është i shkruar me dorë nga Mëhill Kostandin Gjeci - Kryeziu. Nëse do të gjendej ky libër do të ishte një ngjarje jo vetëm për Kryeziun, por për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe të Kosovës.

Rrugës për në Kryezi takojmë miq e udhëtar të panjohur. Flasim me ta. Përvec të tjerave u themi se e kemi makinën, por po lëvizim në këmbë për të hequr ca "dhjam" të tepërt. Unë në mënyrë të veçantë u tregoj malësorëve të Kryeziut se po mbledh disa fakte rreth vizitave që ka bërë dikur Dritero Agoli në Kryezi kur ai ishte gazetar i "Zërit të Popullit". Po shkruaj një libër për ato që më ka rrëfyer poeti dhe gazetari i njohur. Unë kam mbushur disa blloqe me shënimë nga ato që më ka rrëfyer Dritero Agoli kur ai kishte qenë me shërbim nga gazeta në fshatin Kryezi. Driteroi më ka molloisur se ai tre ditë në Kryezi ka qenë mysafir tek Mark Dodë Alia. Dritero Agollin e shqoqëronte mjeku Alfred Serreqi. E kisha intervistuar Dritero Agollin në shtëpinë e tij në Tiranë. Por kam biseduar më të edhe kur ai ishte deputet i Kuvendit të Shqipërisë. Me shumë emocion Dritero Agoli më ka treguar se atij ka bërë një pritje të paharrueshme Mark Dodë Alia. Natyrish që miqësia me Mark Dodë Alinë i hapi telashe gazetarit të "Zërit të Popullit" Dritero Agollit. Familja e Alisë kishte cene në biografi. Për këto e kritikan Dritero Agollin në kollegumin e gazetës. Por publiciti i njohur nuk qe thyer. Ai kishte folur fjalët më të mira për famjen e nderuar



në Kryezi siç qe familia e Mark Dodë Alisë. Para se të vija në Kryezi unë i shfletova blloqet. Driteroi në sy të Sadiges më kishte thënë se se në odën e Mark Dodë Alisë atë dhe mjekun Alfred Serreqin i kishin pritur me të gjitha të mirat. Mish, raki, djath, byrek, fli e ëmbëlsira. Mark Dodë Alia kishte ftuar miq dhe të afërmitt e Aliajve sipas zakonit. Kishte buçitur oda nga këngë dhe vallja. Vet Dritero Agoli kishte hequr valle. Në odë qenë treguar historira pa fund. Dritero Agollit në piye e sipër i kishin kërkuar që dhe ai të tregonte ndonjë ngjarje nga jeta e tij në jug të vendit. Dhe Agolli nuk kishte përtuar. Ja një nga tregimet e Driteroit të rrëfyer në odën e Mark Dodë Alisë. Unë u kishte thënë Dritero Agoli para se të vija në Kryezi isha në fshatin Gradec të Skraparit. Edhe aty i zoti i shtëpisë kishte shtruar një darkë dhe kishte ftuar miq e shok. Oda qe mbushur plot e përplot. Por në fshatin Gradec kishte një zakon të egër. Në fund të shtëpisë përdhese ishin me dhjetra hunj. Në çdo hu do të lidhej me litar dhije ai mik që do të dehej nga dollitë. Nuk pinte vetëm i zoti i shtëpisë. Ai mik që nuk do të dehej dhe do të shpëtonë pa u lidhur do të merte një dash si dhuratë. Qëllimi i asaj darke ishte qe të dehej Dritero Agoli dhe ai si të gjithë të tjerët të lidhej me litar pas një huri. Filloj dollia me nga shtatë e me nga nëntë filxhan plot me raki. Filluan të dehen të gjithë ata që i kishte ftuar i zoti i shtëpisë sipas zakonit të Gradecit. Dhe i zoti i shtëpisë të dehurit i lidhët një e nga një në hunjtë në fund të odës ku qe shtruar darka. Kaloi mesi i natës. Dolën yjet në majën e Tomorrit. Dritero Agoli vazhdon të pinte raki pa e prishur terezinë. Ishte esell. Më në fund i zoti i shtëpisë e mbyll darkën. Dritero Agollit që nuk u deh dhe që shpëtoj nga lidhja me litar në hu i thanë se në mëngjes do të merte për në Tiranë një dash që ishte pas derës.

Jemi larguar shumë nga Ura e Bardhetit. Anës kthesave të lumbit të Kryeziut kemi folur për prjësat si Bajram Curri, Hasn Prishtina, Azem Galica e të tjerë që janë strehuar në Kryezi. Unë mendjen e kam tek kapitulli që do të shtohet librit kushtuar Dritero Agollit e që do ta batoj Mehmet Gëzhilli. Nuk do të shkoj tek trolli i Mark Dodë Alisë. E kam filmuar dhe fotografuar kohë më parë. Trashgimtar Tonin Alia, i cili është një biznesmen i suksesshëm kullën e të parëve të tij e ka përshtatur për një vilë historike. Ai ka studjuar pemën gjenealogjike të familjes Alia. Dhe Shtjetëfën Gjeçovi është i kësaj peme. Tonin Alia pemën gjenealogjike e ka reklamuar në sofën Pukjane. Për këtë cështje kam një ese në dore.

Në një nga kafenetë e Kryeziut unë hedh në letër ato që më kanë thënë anës lumbit të moshuarit e Kryeziut për poetin Dritero Agoli. Udhën nga erdhë gazetari, urat ku kaloi mbi lumin e Kryeziut, intervistat që mori për "Zërin e Popullit", cigaret që ndezi tek Qershët e Gjeçovit, këngët që mbajti shënim, baldat, legjendat dhe vargje nga Eposi i Kreshnikëve: /Kur ka nis mali me dushkue/A ndal qyqja n'muran't' vorrit të ri//Ka gjet' blinin të tan' degash tha/.

Vet Dritero Agoli ka treguar se atij malësorët e Kryeziut i kanë folur për engjet e Kunorë Dardhës. Edhe kaprollet janë engjet. Po të shikosh një kaprolle në Kunorë Dardhë dhe t'i vërvhëlesh ajo ndalon dhe të sheh në sy. Prandaj në Kryezi të nëmin po të vrasësh një kaprolle. E kanë të shënjtë. Në Kunorë Dardhë ka disa "vende të mira". Po të shkelësh në to nuk të zë magjia e zezë, bëhen me fëmijë ato gra që nuk lindin, të shtohet bereqeti e nuk

dëgjon lajme të liga.

Në shtëpinë e tij Dritero Agoli në Tiranë më pati treguar një ngjarje të cilën e kishte qëmtuar në Kryezi, por që kishte ndodhur në një fshat tjetër emrin e të cilit nuk ka ja kishin treguar. Një bari delesh që qe ngritur herët për të nxjer delet në kullotë kishte dëgjuar në një kasolle të braktisur tek po qante një foshnje. Bariu qe futur në kasolle. E kishte mbështjellë foshnjen me fanellën e lesht dhe qe nisur për në maternitetin më të afërt. Foshnjes gjatë rrugës i jepte pika qumështi. Përfat fëmija shpëton në maternitet. Por gazetarit Dritero Agollit i kishte lënë mbresë të veçantë se në mëngjes në kafenën përball materintitetit nuk zihej në gojë "kopili" e të tjera. Në kafene diskutohej heroizmi i bariut që me foshnjen ilegale kapërxeu malin dhe e shpëtoi atë. Kjo kishte ndodhur në socializëm.

Shënimet e Dritero Agolit janë të shumta për Kryeziun. Si nuk po i mbledh dot të gjitha tregimet e Kryeziut kishte thënë në sofrën e Mark Dodë Alisë kishte thënë poeti. Po më zë dimri. Dhe të zotët e shtëpsë i kishin rrëfyer për një gjaijtë nga Kryezi. Ai gjuante nëpër guvat e lumi. Ishte pranverë. Gjahtari e kishte filluar gjuejinë guvë më guvë qysh aty ku fillon burimet e Kunorë Dardhës. Çdo ditë që gjuante lumi fshihej nëpër zall. Dhe gjaijtari mezi i zinte burimet që shfaqeshin befasisht. Por një ditë duke gjaujtur ndjeu se që nga lart po vinte me uturimë uji i turbullt. Gjahtari çuditet. Në majën e Kunorë Dardhës kishte rënë bora e parë. Dhe burimet e thara qenë mbushur e kështu lumi i Kryeziut kishte shkuar në shtratin e tij. Bobo kishte bërtitur gjaijtari. Më paska zënë dimri.

Në tregimet e Dritero Agolit zinte vend dhe poemë "Dhjetë sy". I kushtohej komandantit Bardhok Jakut nga Puka. Agoli kishte shfletuar faqen e ditarit të kufitarit: "Dje dëbora e bjeshkës gjellti pesë kufitar, që ishin nisur të zinin Qafën e Ali Çelës, ku mund të kalonte armiku". Ishin bandat e Udb-së. Ja si e mbyll poemën poeti për komandantin Bardhok Jakut dhe katër kufitarët që dhanë jetën/Këtu dëbora e maleve të lart//E flakur nga tufani i tërbuar//I mbylli dhjetë sy//Të zesë//Të kaltër//I mbylli dhjetë sy të dashuruar.

Për t'i dhënë dorën e fundit reportazhit më duhet të takoj dhe Tonin Alinë. Mora vesh se kishte qenë në vëprimtarinë kushtuar "Sofrës Pukjane". Më duhet dhe ndnjë motiv tjetër për Dritero Agolin. Por kam dhe një merak. Doja ta pyesja për mikun e tij Hashim Thaçin. Thuhet se është nga Thaçët e Pukës. Në Zym të Kosovës Tonin Alia na mundësoi të bënim disa foto me Kaomanstantin e Uçk-së Hashim Thaçin. Kur të kthehem në Tiranë do t'i kopsis ato që nuk i gjeta vola dot në Kryezi.

Gjithashtu me Bilbil Dervishin më duhet të shkoj dhe tek kullat e të parëve të tij. Mbështjellës në librin që kam nëpër duar për Dritero Agolin do të shtoj ndonjë xhevair. Ati i mikut tim u mësonte fëmijëve të gjitha veglat muzikore dhe këngët e Kryeziut. Hallet në familje mundëshin me melodi dhe me këngë e humor. Ne në Mallakstër themi "Me këngë e të qeshur, të zezat përqeshur".

Nëpër luginën e Kryeziut shoh që vijnë makina me emigrant. U emocinoval. Dhe mu kujtua një histori me ushtarët e Odiseut. Ushtarëve të Odiseut u dhanë një ilaq magjik që quhej lotus. Po ta piye këtë ilaq të rrallë e harroje atdhenë. Por ushtarët e Odiseut nuk e pinë ilaqin. Dhe nuk e harruan atdheun. U kthyen në Itakë. Kështu do të ndodh dhe me shqiponjat e Kryeziut. Kurrë nuk do ta harrojnë Kryeziun dhe Pukën.

Kriteri shkencor kronologjik, i ndjekur nga autorri Mihallaq Konda i ka dhënë librit vërtetësi dhe besueshmëri

# Vlerat dhe dukuritë e reja të historikut të Brigadës së IV S

*• Mihallaq Konda si historian i përgatitur dhe me përvojë, si publicist i mirënjohnur dhe i apasionuar për historinë ushtarake ka zbatuar gjatë hartimit të historikut kritere shkencore për një vepër të tillë.*

*Ai për një kohë të gjatë ka shfrytëzuar dokumenta në arkivat dhe muzetë e vendit, si dhe burime bibliografike të shtypit të përditshëm që pasqyronin rrugën luftarakë të Br. IV S*

**Prof. Asoc. Dr. Bernard Zota**

Në kuadrin e 80 vjetorit të krijuar të një prej njësive më të hershme të LANÇ-it, Br. IV S, kemi nderin dhe privilejin që si historianë ushtarak të sjellim disa nga vlerat dhe dukuritë e reja të historikut të këtij formacioni luftarak. Për një periudhë mbi 20 vjeçarë historiani ushtarak Mihallaq Konda, ka arritur të kurorëzojë me sukses misionin e tij për bëren e "Historikut të Brigadës IV Sulmuese", të ndihmuar nga një grup kuadrosht drejtues të brigadës.

Historiku i Br. IV. S nuk mundi të shohë dritën e botimit si historikët e Br. I, V, VI S para viteve 1990, por kjo u bë e mundur me kujdesin e Familjeve Konda dhe Trebicka në vitin 1998. Për vet kohën dhe kushtet në të cilat u publikua historiku ishte një arritje.

Luftëtarët e brigadës që ishin ende në jetë, partizanë dhe kuadro, e vlerësuan botimin, si një përpjekje e mundit të luftëtarëve që në një periudhë kohe kaluan në male e shtigje, në aksione luftarakë, në rrugën e gjatë të lirisë dhe të çlirimtë vendit dhe së bashku bënë të mundur hartimin e historisë së brigadës të tyre luftarakë.

Mihallaq Konda si historian i përgatitur dhe me përvojë, si publicist i mirënjohnur dhe i apasionuar për historinë ushtarake ka zbatuar gjatë hartimit të historikut kritere shkencore për një vepër të tillë. Ai për një kohë të gjatë ka shfrytëzuar dokumenta në arkivat dhe muzetë e vendit, si dhe burime bibliografike të shtypit të përditshëm që pasqyronin rrugën luftarakë të Br. IV S.

Vlera e librit qëndron në kriterin bazë që ka ndjekur autorri, i cili është kriteri shkencor kronologjik, duke i dhënë gjithë librit vërtetësi dhe besueshmëri. Nëpërmjet kësaj vlerë autorri në realizimin e misionit është mbështetur dhe ballafakuar me një dokumentacion arkivor, kryesisht shqiptar, me fonde nga arkivat shqiptare dhe nga muzetë e vendit.

Ai, si një hulumtues i thellë i dokumentave, plotësoi me përsosmëri të gjithë rrugëtimin e brigadës duke shfrytëzuar çdo detja të tyre, dhe vendosi kriteri shkencore edhe për kujtimet e luftëtarëve, që sipas kritereve të njohura të historiografisë, në mungesë të dokumentave, marrin vlerën e burimeve parësore.

Historiku i shkruar prej historianit ushtarak Mihallaq Konda u shkrua me zemër e pastërti, u shkrua me shpirtin e luftëtarit, u hartua me pasion së bashku me kolegët e tij. Shkrimi i historisë së brigadës, të biografisë së saj, i dha përfjetimin e gëzimeve dhe emocioneve të rrugës historike, të vështirësive të njëpasnjëshme dhe të shumëlojshme në luftë, por dhe në këtë mision e në këtë proces të veçantë të saj.

Historiku pasqyron me vërtetësi rrugën e lavdishme të Brigadës IV Sulmuese, të njerit prej formacioneve më



të shquar të UNÇSH, pasi në radhet e kësaj njësie ishin grumbulluar luftëtarë me përvojë dhe të shkolluar, të rinj dhe të reja që kishin kryer aksione të guximshme në njësitët guerile, në çetat dhe bataliontë partizane, patriotë dhe luftëtarë të vjetër që ishin ndër të njohurit në Qarkun e Korçës, por dhe në Shqipëri për vlerat e tyre. Në historik pasqyrohet me vërtetësi roli i PKSH dhe komandantit të Luftës Enver Hoxha, për organizimin, përgatitjen luftarakë, përbetejat dhe shfaqjen e vlerave morale të kësaj brigade. Në të gjithë rrugëtimi e saj luftarak prej më se 6.000 km, luftëtarët e brigadës shfaqen me një dukuri të re, atë të vlerave morale dhe luftarakë. Populli i Qarkut të Korçës me të drejtë e ndjenin veten krenar për kontributin e shquar të dhënë nga luftëtarët e kuadrot e Br. IV S në çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit e huaj fashisto-nazist dhe tradhëtarët e vendit.

Historiku pasqyron jo vetëm dukuri të vepprimeve luftarakë, por paraqet dhe aspekte të tjera të jetës dhe veprimtarisë së brigadës, paraqet sakrificat dhe heroizmin kolektiv dhe aktin heroik të rënies së luftëtarëve të saj, pasqyron motivet atdhetare dhe ndjenjat liridashëse me të cilat ishin frysue luftëtarët. Në të pasqyrohet në mënyrë të dukshme dashuria dhe lidhjet e partizanëve me popullin, ku ishin bazat dhe streha e tyre në luftë.

Historiku i ri i kësaj njësie sulmuese e shëh dritën e botimit në një kohë prej 80 vitesh, por që kur e lexon të duken se luftimet dhe partizanët janë të paranishëm. Edhe pse në këto vite të demokracisë është hedhur baltë e llucë, botime të tillë me një vlerë të re, i sjellin shoqërisë vlera për të cilat populli dhe rinia ka nevojë përbote më tillë.

Janë përpjekur forca të caktuara që Lëvizjen dhe Luftën Antifashiste Nacionale çlirimtare, pjesë e së cilës ka qenë dhe


Br. IV S, ta paraqesin këtë luftë jo atdhetare, por luftë civile, duke mohuar rolin çlirimtar të vendin nga pushtuesit dhe tradhëtarët. LANÇ-i shtroi rrugën e çlirimtës së Shqipërisë dhe finalizoi misionin historik, rreshtimin e Shqipërisë në krah të Koalicionit të madh Antifashist të përbërë nga Anglia - BRSS - SHBA; duke zënë një vend nderi në rezistencën europiane përgatitës, intensiteti, arrijet dhe shkalla e angazhimit të forcave fashisto naziste në raport me numrin e popullsisë së vendit, dhe se kjo luftë përbën kapitullin më të ndritur në historinë e Shqipërisë, që nga lashtësia në kohët moderne.

Vlera e librit qëndron në misionin përgatitës, duke publikimin në mënyrë sa më të plotë, të dokumentuar të organizimit, të luftimeve, të ndjekjes së situatave luftarakë, të përgjegjësive të çdo partizani për të kryer sa më mirë detyrën karshi familjes dhe Atdheut.

Librit i shtohet vlera sepse ka prurë disa prej figurave e personaliteteve kryesore drejtuese të Br. IV S. Këta ishin luftëtarë që u mbështetën nga qindra partizanë shqiptarë, të cilët u organizuan, u përgatitën në beteja dhe luftuan me pathos të madh duke hedhur dhe bazat e krijuar, të organizimit, të zhvillimit e të përmirësimit të Ushtrisë Popullore.

Në këtë libër autorri ka arritur të evidencojë dhe të ndriçojë qartë veçoritë dalluese organizative ushtarakë tipike, duke bërë dallim nga aksioni në betejë në çdo etapë të zhvillimit të luftës. Ai ka përdorur metodën e krahasimit dhe gjuhën e shifrave të dokumentuara, brenda hapësirës dhe të mundësive të materialit dhe dokumentacionit përkates.

Autori gjatë zhvillimit të çështjeve ka përdorur metodën kronologjike, kjo e gërshtuar brenda kapitujve me probleme të aspekteve të veçanta, duke i gjykuar si më të mundshmet. Në libër vijnë partizanë dhe dëshmorë të cilët



dëshmojnë për një rrugë luftarakë dhe për një histori suksesesh.


Vlerën e këtij botimi unë e shoh edhe në një aspekt tjeter. Në vitet '80, Akademia e Shkencave dhe Akademia Ushtarake ndërmorën botimin e historive të qarqeve për periudhën e LANÇ-it dhe të brigadave të UNÇSH. Në këtë proces u bënë disa botime dhe një numër hapash të tjerë në këtë të drejtim. Në vitet '90, mjerisht, ky proces ngriu. Libri që u promovua më 21 dhjetor 2023 shkrin këtë akull për Br. IV S. Qoftë i lavdërueshëm dhe frysue ky veprim! I lumtë nismëtarëve të botimit, familjes Trebicka dhe Konda, familjarët e të cilëve kanë qenë pjesëtarë aktivë të këtij formacioni luftarakë. Qoftë ky libër me këmbë të mbarë dhe hap të sigurtë në rrugën përbote më të tjera historike me temë të LANÇ-it që vazhdonjë të jenë të ngrirë ose në gjysmë të rrugës!

Ky historik është një muze i hapur i rrugëtimit të një formacioni luftarakë që ka lënë gjurmë në hitorinë e ushtrisë shqiptare. E them këtë, pasi aty ku shkeli dhe luftoi ky formacion la gjurmë të heroizmit masiv dhe historia është dëshmimtare e përpjekjeve dhe të sakrificave të kaluara në luftë nga partizanët, bij të popullit shqiptar.

Së fundi, po jo për nga rëndësia, falënderoj familjen Konda dhe Trebicka, por në mënyrë të veçantë zj. Vjollca Trebicka e cila me një përkushtim dhe admirim të veçantë donte ta realizonte dhe realizoi një dëshirë të babait për të parë dritën e botimit në një format të ri dhe të kohës. Në këtë rrugëtimi pashë përpjekjet e bëra nga të parët dhe baballarët tanë, por dhe vazhdimin e stafetës nga bijtë e tyre. Unë pashë se gjatë përgatitjes së këtij libri, Vjollca, bija e Mihallaq Kondës e ka ndjekur hap pas hapi duke u bërë një këshilltare e rregullt dhe e kohës në mendime dhe në gjykime. Respektë për përkushtimin Tuaj e nderura zj. Vjollca dhe lutem që rrugën Tuaj ta ndjekin dhe bijtë e tjerë të partizanëve dhe luftëtarëve që në vitin e 80 vjetorit të çlirimtës së Atdheut të kemi prurje sa më të shumta.

Për të gjitha këto vlera që theksova, libri është një botim i arriрë dhe i komplektuar edhe për studim në akademitë tonë ushtarakë, por dhe për studiues të tjerë të historisë.

**OPINION**



Nga Bashkim Hisari

**S**i në shumë vende në botës ashtu edhe në Kosovë, është traditë e kahershme që para fundvitit, të dashurëve, miqve dhe bashkëpuntorëve t'iush shprehim dëshirat më të mira, duke u uruar fat, shëndet, suksese dhe të gjitha të mira. Vitin e Ri 2024, shumë kosovarë do ta presin me gëzime e të lumtur, sepse nga një janari do të kenë liberalizimin dhe do të lëvizin pa viza në zonën e Shengenit, në shtetet e Bashkimit Evropian.

Megjithatë, shumë çështje do të mbeten ende të hapura dhe të pazgjidhura. Në vetëdijen e shumë qytetarëve kosovarë do të mbizotëroj e vërteta për vitin që po e lëmë pas se ishte "i neveritshëm" dhe "i keq". Një vit me punë të papërfunduara, tensione në rritje, me keqkuptime. Me dhunë e të shtëna me armë zjarri deri në vrasje e plagosje të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës dhe paqeruajtësve të KFOR-it. Për këto askush nuk u shpallë përgjegjës para drejtësisë kurse ndaj Kosovës u zbatuan masa të padrejta ndëshkuese që e kanë dëmtuar shumë vendin edhe në aspektin ndërkombëtar.

Reformat në drejtësi kanë qenë ndër

# PËR KOSOVËN, VITI 2024, VIT I SHPRESAVE MË TË MËDHA

sfidat kryesore, ka pasur pengesa në sundimin e drejtësisë, ligjit, në luftimin e krimit, korrupcionit, nepotizmit. Ndërkaq, problemet në sistemin e arsimit, në sektorin e shëndetësisë si dhe inflacioni i lartë, papunësia dhe varfëria në rritje bashkë me pasojat e pandemisë Covid-19 dhe frika që ajo ka shkaktuar për jetën e njerëzve, kriza globale ekonomike, energetike, agresioni rus ndaj Ukrainës, bombardimet e vrasjet brutale dhe shkatrrimet në lufën e Izraelit me Hamas që po e rrezikojnë paqen, seriozisht po i brengosin dhe shqetësojnë qytetarët e Kosovës.

Edhe pse Kosova në këtë vit ishte më mirë se në vitin e kaluar, munguan përpjekjet serioze për të demonstruar qartë dhe me zë të lartë vendosmërinë për forcimin e sundimit të ligjit, demokratizimit të shoqërisë dhe institucioneve, pluralizmit politik, respektimit të drejtave të njeriut dhe pakicave kombëtare si garantues i paqes dhe sigurisë në mbrojtje e paqes.

Megjithë faktin se partnerët strategjik qëndrojnë fuqishëm prapa Republikës së Kosovës, në vitin që e lam pas nuk ka pasur njohje të reja, përkundrazi, disa shtete kanë tërhequr vendimet e mëhershme për njohje që është rezultat i kampanjës së Serbisë nëpërmjet të cilës synon t`ia pengon Kosovës subjektivitetin ndërkombëtar. Në anën tjetër, mungesa e një uniteti ndërpartiak qoftë në tema të vogëla apo të mëdha, ka bërë që Kosova të dalë joseriozë ndaj partnerëve strategjik. Të gjitha këto dëmtuanë idealet dhe vizionin e qytetarëve të Kosovës, për ç'arsye, shumë qytetarë u larguan nga Kosova për të siguruar vende të punës dhe një jetë më të mirë iashtë vendit.

Çështjet që mbetën të hapura dhe pa përgjigje si dialogu mes Kosovës dhe Serbisë i lehtësuar nga BE, me

ndihmën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, obligimi për themelin pa vonesë dhe pa kushte të Asociacionit të komunave me shumicë serbe, detyrimet për zbatimin e Planit franko-gjerman për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, njohja e pa varësisë së Kosovës, antarësimi i saj në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në BE, zbardhja e fatit të pagjeturve dhe çdo krimi të kryer në Kosovë, edhe në vitin 2024, do vazhdojnë të jenë në qendër të vëmendjes jo vetëm të qytetarëve në Kosovë.

Në zgjedhjet e parakohshme më 17 dhjetor, Lista e Partisë Përparimtare Serbe "Aleksandar Vuçiq – Serbia nuk guxon të ndalet", fitoi 46.6 për qind të votave që nënkupton 129 ulëse në Parlamentin serb. Andaj nuk duhet pritur që me fitoren e Vuqiqit, Serbia në vitin e ardhshëm të ndryshoj kursin politik të saj karshi Kosovës.

Pala serbe do angazhohet të ngadal-soj procesin e dijalogut me opstrukcioniste duke u kufizuar vetëm në shtyrjen e përballjes me realitetin. Presidenti serb Aleksandar Vuçiq i cili dominon në politikën serbe tani më shumë se 11 vjetë fillimisht si kryeministër dhe më vonë si president, mban tërë pushtetin në duar e tij, është populist dhe minimizon normat demokratike.

Duke ndar njerëzit, në të përshtatshëm dhe të papërshtatshëm në shtetin e tij, nuk dihet kush është polic e kush kriminel. I ndikuar nga ultra-nacionalizmi serb sidomos nga Partia Radikale e ekstremit të djathë të Vojislav Sheshelit i cili nga Gjykata e Hagës u dënuam me dhjetë vjet burgim për krime lufte Vuçiq, duke synuar me marrë toka nga vendet fqinjë përfshirë tërë Kosovën, ëndërron krijimin e Serbisë së Madhe. Ai ka marrë pushtetin dhe ka vendosur një diktaturë që është e ngjashme me

sistemet e bazuara në ideologjitetë nacionale-fashiste. Nuk është për tu habitur, mbase në vitin 1998, krimineli serb Sllobodan Milosheviç e emëroi Vuçiqin si ministër të informacionit. Në qeveri, ai ishte përgjegjës për zbatimin e disa prej ligjeve më kufizuese të lirisë së fjalës. Disa ditë pas masakrës së Srebrenicës, në korrik të vitit 1995, kur forcat serbe në Bosnje vranë mbi 8.000 burra dhe djemë myslimanë boshnjakë, pat deklaruar: "Nëse Ju vrissni një serb, ne do të vrashim 100 myslimanë."

do të vrasim 100 muslime, Politika e Vuçiqit po determinohet me rrityen e nacionalizmit, shovinizmit, klerikalizimin shtetërt, shkeljën e të drejtave dhe lirive themelore, të shprehjes së mendimit politik pa frikë nga pasojat, e të ngjashme që u dëshmuant edhe në zgjedhjet e fundit. Zgjedhjet i fitoi me manipulime e blerje të votave dhe me votues fantom.

Tolerimi i ekceseve gjithnjë e më të shpeshta të grupeve neofashiste të afërta me pushtetin e Vuçiqit, mohimi i antifashizmit dhe vlerat e tij, rehabilitimi dhe glorifikimi i kriminelëve të dënuar për kime lufte, bashkëpunëtorëve të nazistëve nga Lufta e Dytë Botërore dhe ata nga luftërat e viteve të 90-ta, si dhe përfshirja e ideologjive të tyre fashiste në strukturat e politikës shtetërore - tregojnë se shoqëria serbe po zhytet plotësisht në popullizëm gjithnjë e më agresiv - që është vetëm një emër tjetër për nazi-fashizmin modern.

Pavarësisht nga faktet, historja, provat shkencore dhe analizat racionale që janë në favor të shqiptarëve dhe Kosovës, vështir se mund të jemi optimist që në vitin 2024 do të tejkalojen problemet, zbatohen marrëveshjet, dhe arrihet një kompromis që do rezultoj me një marrëveshje finale për normalizim të raporteve përfshirë edhe njohjen reciprok.

**80 VJETORI - Konferenca e Bujanit gurthemel i shtetësisë së Kosovës**

(Vijon nē faqen 6)

varësisë partiake, vepruan si një pol i tretë midis Partisë Komuniste Jugosllave dhe Partisë Komuniste të Shqipërisë. Pjesëmarrësit ishin kryesish shqiptarë, ku disa prej tyre ishin formuar si kuadro dhe si komunistë në Shqipëri. Ata që ishin shtetas të Shqipërisë nuk i pyetën organet drejtuese të PKSh-së nëse duhet të mbahet apo jo kjo konferencë dhe çfarë duhet të thuhet në të. Po ashtu, edhe komunistët shqiptarë të Kosovës me shtetësi jugosllave, nuk u morën leje organeve drejtuese të PKJ-së nëse duhej mbajtur kjo konferencë dhe çfarë duhej vendosur aty. Pra, për organizimin dhe vendimet që u morën në Konferencë, pjesëmarrësit vepruan si një parlament me përfaqësues të zgjedhur nga zonat veriore të Shqipërisë, pa një udhëheqje të qartë partiake ose shtetërore, duke vepruar në kohën e duhur për Kosovën, duke u formuar de faktu dhe de juro qeveria dhe parlamenti i pare në Kosovë. Me një filozofi të veten politike në rrugën e saj evropiane Kosova do të riafirmonte vlerat e saj tradicionale që përcaktojnë orientimin politik afatgjatë. Një nga këto vlera është përcaktimi i vijës antifashiste, e cila u bë në kohën dhe në momentin e duhur. Aq sa ishte e vështirë dhe e ndërlikuar Lufta e Dytë Botërore në Kosovë kundër armikut, aq më e madhe është merita e lavdia e atyre që u hodhën në luftë dhe e organizuan rezistencën e saj. Njëri nga bartësit kryesor të këtyre ideve në Bujan dhe nismëtar i orëve të para të punës konkrete ishte mësuesi nga Gjakova, Fadil Hoxha, komunist me bindje, më vonë një nga udhëheqësit kryesorë të Kosovës dhe një nga udhëheqësit më të lartë të Jugosllavisë Federative.

Veprimtaria e Fadil Hoxhës, duke filluar prej Konferencës së Bujanit e deri në mbarim të angazhimit politik të tij në Kryesinë e ish-Federatës Jugosllave më 1984 dhe duke përfunduar veprimtarinë e tij në Shoqatën e Veteranëve të LNÇK-së deri në vitin e vdekjes, përkatësisht më 2001, ishte e dendur. Fadil Hoxha ishte njeriu, luftëtar, komandanti, politikani dhe burrështetasi, i cili me punën, përkushtimin

dhe veprën e tij jetësore i dha vulë një periudhe historike për më shumë se 50 vjet, por që me vlerat e saj tejkalon suazat kosovare dhe ato kombëtare. Për këtë dëshmon Jan Merret, ushtarak i misionit anglez i dërguar në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, në kujtimet e tij, ku do të shprehej: "Fadil Hoxha ka qenë një udhëheqës i respektuar i luftës në Kosovë". Është pa dyshim një nga figurat e rëndësishme shqiptare të shek. XX. Ai në veçanti u angazhua dhe e ndihmoi me bindje të plotë procesin e shkollimit e të perfektionimit të kuadrove të të gjitha profileve, aq shumë të nevojshme për Kosovën, për fatet dhe për ardhmërinë e saj, duke jetësuar së bashku me bashkëpunëtorët dhe bashkëmendimtarët e tij devizën "Nga Abetarja deri tek Universiteti dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës".

Në saje të luftës që bënë shqiptarët e vendit tonë, shqiptarët e Kosovës nuk e pësuan fatin e vëllezërve që u dëbuau me forcën e armëve nga serbët në vitet 70 të shek. XIX nga zonat e Sanxhakut të Nishit dhe të popullit çam në Greqi. Pastaj shpërngulja e më se 10 milionë gjermanëve nga Shelzia, Krakovia dhe e folldojcerëve nga Vojvodina. Do të mbetej i madh ndikimi dhe orientimi i Konferencës së Bujanit për shqiptarët në periudhat e përfundimit dhe pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, por edhe në vitet që do të pasonin në proceset në të cilat do të kalonte Kosova, ku nuk mund të flitej për të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavi, e të mos u referoheshin vendimeve të Bujanit. Kështu ajo do të bëhej busulla, ku udhëheqja shqiptare, në periudhat e ndryshme historike, pas luftës globale, në sferën politike, në momentet e transformimeve kualitative të situatave në Jugosllavi, do ta përdorte në dobi të efikasitetit, që gjithnjë dhe më tepër, fryma e kësaj Konference, të jetë aktive dhe e angazhuar në zgjidhjen e çështjeve të shoqërisë shqiptare, që viset shqiptare në Jugosllavi, sikurse subjektet e tjera të federatës, të merrnin përgjegjësitet e tyre, në mënyrë që vetëqeverisja, t'ua siguronte shqiptarëve të drejtat e tyre të pakontestueshme, që do t'i kërkonin në vitet 1968, 1981, 1989-1992, 1998-99 deri me shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008.

**HISTORIA**

*Brigada që përshkoi deri 1500 km rrugë e la gjatë luftimeve 208 bijë e bija nënash si lapidarë të pëjetshëm*

# 80-VJETORI, Brigada e 6-të Sulmuese i shkaktoi armikut 3500 të vrarë dhe rreth 5000 të plagosur

Në fillim të vitit 1944, Lufta Nacionalellirimitare mori permasa te medha. Përballë Operacionit armik të Dimrit ishte e nevojshme të shtohej edhe forca goditese e paartizanëve kunder armikut. Ne keto kushte midis formacioneve te tjera, me 26 Janar 1944, u formua Brigada e 6-të Sulmuese, ne qytetin e njohur per tradita kulturore e atdhetare te Permetit. Në Brigade u reshtuan kuadro e partizane te sprovuar ne luftime te meparshme dhe formacione ekzistuese si: batalioni "Hasim Zeneli", "Abaz Shehu", "Naim Frasherri" etj, me një efektiv prej 912 luftetaresh. Komandant i saj u emerua atdhetari i shqaur Tahir Kadare, komisar Mustafa Matohiti, Zv/Komandant Jaho Gjoliku dhe Zv/Komisar Haki Toska. Si dhe ne batalione e kompani u emeruan kuadro te sprovuar.

Karakteristike eshte se kjo Brigade ne formim e siper, u ballafaqua me luftime, sepse u godit nga gjermanet ne tre drejtime nga Janina, Berati dhe Gjirokastra, sulmi u shoqerua me farsimin e lumen Vjosa, duke perdonur gomone e mjete te rastit. Nderkohe komanda e Brigades mori masat e domosdoshme, duke zene pozita te rendesishme, per te mos u futur ne gracken e armikut, si forcat e vete



brigades, ashtu edhe populli i Permetit. Batalioni "Hasim Zeneli" u hap ne rajonin Kukal - Kosine, ai "Abaz Shehu" ne pjerresit e Dhembelit permbi Permet, batalioni "Naim Frasherri" ne malin e Bardhe - Petran, kurse ai i "Baba Abaz" ne Kukar. Sulmit te partizanëve ju paraprinë masat e marra, ndërkohë që dalohej vtmohimi i efektivit te Brigades. Pas njezete kater ore luftimesh gjermanet u thyen, duke pesuar humbje te medha ne njerez dhe teknike. Kurse nga

ana jone nuk pati asnje demtim. Kjo, jo vetem rriti moralin e partizaneve, por dhe terheqjen vullnetarisht ne Brigade te 40 vajzave e djemve te tjere. Armiku i acuar nga çka pesoi ne ato luftime, filloj masakrat ne drejtim te qytetit duke djegur edhe disa shtepi. Ishte koha e operacionit Gjerman te Dimrit. Prandaj forcat e Brigades u angazhuan menjehere ne luftime, kunder tyre, si ne krahinen e Permetit e ne rrafshnalten e Zagorise, deri edhe Luginen e Vjoses,

sepse ne keto zona ata kishin perqendruar forcat e mbeshtetjes, per njësitë kryesore Gjermane qe vinin, nga Konica ne drejtim Permet - Berat. Me tej me 29 Mars 1944, Brigades i erdhë urdheri nga lart dhe me një batalion sulmoi Patosin e kryesisht Kalane e Margelliçit ku ishin te disllokuara rreth 2000 forca gjermano - balliste. Ne mengjek pa u gdhire per rreth një ore rrrethuam dhe morem kalane, duke kapur shume armatim e materiale trofe, si edhe rober. Ne kete luftim na ngelen te vrare "Heronje e Popullit", komisari i Brigades, Mustafa Matohiti; Zv/Komandant Batalioni Meleq Gostinishti, komisar i kompanise Lefter Talo. Gjate operacionit te Qershori Brigada e 6-te ne bashkeveprim me Brigaden e 12 kreu detyra dhe luftime ne zonen e Delvines, Sarandes, Borshit, Kuçit, Bolenes, Mavroves, Mazharit e Gumenices e ne pergjithesi gjate Lumit te Vlores etj, ku ishin te perqendruara forcat me te shumta te armikut dhe me qe ato ishin te tilla, na erdhë urdheri qe ne veprimet te mos i kryen kompakte, por me te shperndara e ne grupe te vogla, sa me te manovrueshme, per ta goditur armikun ne befasi e ne shume pika.

Ne muajin korrik, brigada mori urdher te marshonte drejt Shqiperise se Mesme. Ne Salari prane Dukajt shpartalluam një bande mercenaresh, ku na u vra Heroi i Popullit Mitro Xhani nga Piqerrasi qe bente pjese ne Batalionin "Zaho Koka". Me tej ne muajin gusht, vazhduam marshimin ne drejtim te Kercyres e Skraparit, ku u inkuadrue ne perberje te Divisionit te Dyte, duke goditur autokollonat gjermane ne Labinot, ku u vra edhe Zv/Komandanti i Batalionit Balil Peçi. Ne vazhdim kaluan ne zonen Martanesh - Mat - Puke, te cilen pas luftimesh te aspra dhe e çliruan. Pastaj vazhduam marshimin ne drejtimin Iballe - Dukagjin te Malesise se Madhe dhe një dite para çlirimt te Shkodres, brigades ju dha urdheri te kalonte kufirin, per ne Malin e Zi duke u angazhuar ne luftime gjate rruges Podgorice - Kolashin e ne zonen e Verushes deri ne Vishegrad. Keto luftime beheshin neper ngrrica akulli e kushte atmosferike teper te vesh-tira e megjithate çliruan Kolosianin. Ne ato luftime ra heroikisht Zv/Komisari i kompanise Loni Jani dhe një komisar kompanie, Muke Ilmi Topi dhe komandanti i kompanise Gjeli Gogo. Ndersa ne Drishtan te Vishegradit duke luftuar ne kushte teper te veshtira moti e terreni na u vra zv/komandanti i Batalionit "Baba Abaz" Lame Kamani.

Gjate gjithe luftimeve deri ne mbarim te luftes, kjo brigade i shkaktoi armikut humbje te renda, si 3500 te vrare, rreth 5000 te plagosur, 1957 rober si dhe iu kapi 400 mitraloze, 100 makina e tanke e shume teknike tjeter. Pershkoi deri 1500 km rrugë e la gjate luftimeve 208 bije e bija nënash si lapidare te perjetshëm ne nderim te kombit. Brigades i eshte akorduar titulli i larte "Hero i Popullit" si dhe 10 heronj, midis tyre dy te gialle. Shembull i asaj brigade do te ngelet perjete, simbol per sot e brezat e ardhshem si histori e shkruar me gjak.

## RISHKRIMI I HISTORISË TI SHËRBEJË BASHKIMIT DHE JO PËRÇARJES SË SHQIPTARËVE

(Vijon nga faqja 7)

ishte udhëheqësi kryesor, ashtu dhe në periudhën e quajtur të ndërtimit të socializmit. Pluset e minuset e tij, tashmë janë të njohura. Por të qëndrojme te pyetja që ju bë profesorit, të cilës ju përgjigji prerë: Asnjëherë! Pra Enver Hoxha kurrë nuk i paska dëmtuar interesat e vendit dhe popullit tonë. Tani t'i marrim me radhë: A nuk ishte ai që iu nënshtrua diktatit të emisarëve jugosllavë, dhe denoncoi traktatin e Mukjes, duke sjellë kështu përcajen e madhe? A nuk ishte ai që shpartalloi fraksionin e Vlorës vetëm pse ata donin të mos vareshim nga jugosllavët dhe kërkonin Shqipërinë e bashkuar? A nuk ishte ai që shpalli në Berat se unë veproja sipas porosive të Miladinit dhe se qenia ime në krye të partisë u bë formale? A nuk ishte ai që mohoi gjithë ndihmën e aleatëve perëndimore gjatë luftës dhe përzuri misionet e tyre diplomatike nga Shqipëria? A nuk ishte ai që në mbledhjen e Byrosë tha se tani e tutje, popullit duhet t'ja bëjmë të qartë se Sekretar i Përgjithshëm nuk jam unë, por mareshalli (Tito)? A nuk ishte ai që i kërkonte J. B. Titos se ne kemi vendosur që Shqipëria të bëhet Republikë e shtatë e Jugosllavisë, por na sugjeroni mënyrën sesi do ta realizojmë ligjërisht? A nuk ishte ai që asnjëherë nuk e ngriti aso kohe problemi e Kosovës, ndërkohë që këtu e mbushi vendin me portretet e Tito shpëtimtarit dhe buçisnin rrugët nga himnet kushtuar atij? Po sa djem kosovarë që ikën nga skëterra tististe dhe erdhën në tokën amë, u burgosën, internuan dhe pushkatuan më pas me dyshimin se janë agjentë. Po prerja e marrëdhënieve deri ekonomike me Rusinë pse ata kishin teorinë e bashkekzistencës paqësore apo me Kinën, se kishin pritur H. Kissingerin dhe Presidentin Nikson apo kishin teorinë e ri botëve, a nuk i solli dëm të madh interesave të Shqipërisë që u varfërua deri sa e mbajti shpirtin me tallona? Tani del ndonjë zë që pretendon se Enveri ishte përhapjen e vendit drejt Perëndimit. Këtë mund ta besojnë vetëm naivët, nostalgjikët dhe brezat e pas nja dy a tre shekujve. A nuk janë dënuar rëndë njerëzit tanë për një muzikë, një revistë, një veshje perëndimore, a për një fjalë goje që i bënte jehonë jetesës atje? Po kush na mbylli me tela

me gjemba duke na ruajtur me ushtarë me automatik në dorë dhe kush u vuri zhurmues televizorëve që edhe për të parë mat'anë të mos kishim mundësi? Mjaftojnë vetë krimet e pranuara prej udhëheqësve të asaj kohe, për të gjykuar me objektivitet komunizmin shqiptar në regjimin e Enver Hoxhës. Se dëmi nuk qëndron vetëm te malet e detet, por edhe te shpirti e liritë e njerëzve. Frikë rrëqethëse nga sigurimi i shtetit e spiunimet, mos vallë nuk i ideoi dhe instaloi ai, stalinisti i deklaruar? Pra, a nuk janë këto e të tjera veprime monstruoze, ato që i bënë dëmin më të madh shqiptarëve? Këto nuk i mbulojnë dot as ajo që u bë për arsimin, shëndetësinë, hidrocentralet, rrugët, bujqësinë, industrinë etj. pasi po ta gjykojmë këshitu, na dalin burra të mirë edhe diktatorët përbindësha Hitler e Musolin. Nuk ka shtet në botë që nuk i bën këto, se fundja është mundi, gjaku dhe djersa e masave popullore që u derdh në to. Fundja, nuk ka asgjë të keqe që t'i njihen si merita edhe asaj partie. Por a do të munden historianët e djeshëm t'i ndajnë këto, ndërsa ngulin këmbë se Enveri asnjëherë nuk i ka dëmtuar interesat e Shqipërisë. Po q'duhet bërë më shumë për t'i cënuar këto interesa? Kurse në histori, pa tjetër që ai duhet të ketë vendin e tij, se ai vend nuk i është mohuar edhe Neronit me shokë. E gjithë kjo sjell domosdoshmërinë e angazhimit të historianëve të qëdo krahu, rrahren e mendimeve të tyre, studimin e gjithë sa kanë shkruar pararendësit, prurjen e dokumenteve autentike, unifikimin e përcaktimeshve dhe definicioneve deri në daljen me një tekst të përbashkët. Si përfundim, mendoj se nuk duhet shpejtuar në rishkruarjen e historisë, se jemi ende nën efektin e trullojës e mospatitimeve parimore të vetë atyre që nuk e kanë aq të lehtë të dalin mbi veten, për të mbërritur te porosia e Lukianit se "Historia ka një detyrë dhe një qëllim të vetëm - të dobishmen dhe kjo e dobishme nuk mund të ketë burim tjetër veçse të vërtetë". Rishkruaja e historisë së vërtetë, për ne shqiptarët është më shumë se kaq; ajo nga ana e saj është një mision historik që do të ndikojë fuqishëm në bashkimin dhe jo në ndarjen e popullit të lodhur nga goje që i bënte jehonë jetesës atje? Po kush na mbylli me tela

ATDHEDASHURIA

# Velmishi në gjurmët patriotike



## Nga NURI BUFI

Fshati Velmish ndodhet në rrugën nationale Fier-Berat, në kilometrin e 20-të në përbërje të njësisë bashkiake Roskovec. Pamja e këtij fshati është mjaft magjepsëse, është fshat që shtrihet në një terren kodrinoro -malor në formën e një harku si gjysmë hëne. Ky relief me pjerrësi të butë vazhdon deri në fushat e pjesës së lagjes Çiflik, duke e kthyer atë në një amfiteatër natyror.

Në gjysmën e pjerrësisë së kësaj kordine ekziston një vendburim i hershëm dhe për shumë kohë është shfrytëzuar si i pijshëm nga banorët vendas. Ishte paksa i ëmbël, shije të cilën sipas një legjende ia kishin bekuar zanat.

Në jug-lindje kodrat e Velmishit, pasohen me disa vargmale më të larra deri në malin e Shpiragut. Për gjatë këtij mali kishin ndërtuar foletë zanat. Zanat, kishin prishur marëdhëniet me fqinjin e tyre në lindje të Shpiragut, me Tomorrin. Ky i fundit, zanave u kishte ndaluar marrjen e ujit nga Osumi. Në këtë rast, zanat shfrytëzuan vargmalet në zbritje si shkallë për të shkuar në vendburimin e Velmishit.

Për ato, ky vendburim ishte i bekuar prej tyre.

Fshati Velmish në shekujt njihet i varfér ekonomikisht, por i pasur për nga mendësia, burrëria, trimëria dhe dashuria për atdheun. Era e patriotizmit në këtë fshat gëlon që nga periuha e hershme otomane dhe në vazhdim të okupimit të vendit nga pushtues të huaj. Banorët e fshatit Velmish kontributin më të madh e dhanë me pjesëmarrjen në lëvizjen gjatë epopesë së lavdishme të luftës antifashiste nacional-çlirimtare, kundër fashizmit gjerman dhe okupatorëve nacionalistë brenda dhe jashtë vendit. Ishin të shumtë djemtë dhe vajzat vullnetarë/e që iu bashkuan çetave partizane si Ja-

godin, Kurjan dhe Sinjë e Posnje të Beratit.

Ata ishin të bindur në luftën e armatosur kundër pushtuesit të huaj si e vetmja rrugë e drejtë dhe që e rreshonte popullin shqiptar në aleancën antifashiste, dhe më pas me formimin e Shtabit të Përgjithshëm të U.N.C.SH më 4 korrik 1943 në Labinot të Elbasanit. Këta burra, djem e vajza mbushën radhët e batalioneve e brigadave partizane.

Ishin këto formacione më të organizuara e të konsoliduara si shprehje e fuqishme e artit tonë ushtarak populor, në luftën kundër okupatorit të huaj nazi-fashist si dhe grupe të tjera reaksionare.

Në ditët e para të muajit shtator 1943, forcat gjermane gjendeshin në juglindje të Beratit dhe Kuçovës dhe kishin forca të shumta në numër dhe arsenali të rendë armatimesh. Në mëngjesin e 12 shtatorit, forcat armike kishin uzurpuar qytetin e Beratit. Ndërkohë nga Shtabi i Përgjithshëm i U.N.C.SH.-së, brigada e 7-të sulmuese kishte marrë detyrë luftarakë për asgjësimin e forcave gjermane të përqëndruara në këtë qytet.

Dëshmi këto që vinë nga partizanët e brigadës 7- të të fshatit Velmish si Nexhip Xhaferri, Ceno Velmishi, Refit Driza si dhe nga Shaban Ramadani e Jonus Buji të fshatit Strum, të cilët tregonin se dy batalionet e kësaj brigadë morën detyrë të sulmonin armikun në rrethim të juglindje të Beratit dhe batalioni i 3 - të me komandant Zylyftar Veleshnja, do të bënin pritë rrugëdaljes së armikut në jug – perëndim të Beratit nga rrafshi lindor i Shpiragut deri në qafën e Sqpurit.

Në mesnatën e 12 shtatorit qyteti i Beratit u ndez flakë, luftimet qenë tëjmase të ashpra deri në trup me trup.

Në këtë mesnatë armiku në tendencë tërheqje në veri perëndim të

qytetit, u përballë me forcat partizane të batalionit të tretë që kishin bërë pritë, në këtë moment nga qafa e Sqpurit deri në dalje të Posnjes.

